



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kuvendi i Komunës

Nr. 001/060-32283

Më: 18 mars 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 43 të Ligjit Nr. 04/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 30 paragrafit 1 dhe nenit 35 paragrafit 2, të Statutit të Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-5643, dt. 15 tetor 2008, thërras mbledhjen e III/2026 (e tretë) të rregullt të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, e cila do të mbahet më: **30 mars 2026 (e hënë)**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në **ora 10:00**.

Prandaj, ftoheni që në cilësinë e anëtarit të Kuvendit të Komunës, të merrni pjesë në punën e kësaj mbledhjeje, duke ju përmbajtur orës, datës dhe vendit të caktuar.

Për punën e kësaj mbledhjeje, propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme të datës 23 janar 2026 dhe mbledhjes solemne të datës 17 shkurt 2026;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin dhe përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi të Komunës së Prizrenit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për Shoqatën “Zona e Pashtrikut”;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e komisionit dhe emërimin e anëtarëve të komisionit për emërimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Prizrenit.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit nr.001/011-60689, të datës 02 korrik 2020 për mënyrën e pagesës së taksës administrative për leje ndërtimore, leje rrërimi dhe tarifa për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.001/011-68302, të datës 29.05.2025;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përgjdhjen e këshillave lokale;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për emërimin e komisionit të ankesave për procesin e zgjedhjes së këshillat lokale.



Kryesuesi i Kuvendit
Simir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Belediye Meclisi
No. 001/060-32283
Tarih: 18 Mart 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Yerel Özyönetim Kanun'un 43.maddesi, 15 Ekim 2008 tarihli ve 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğü'nün 30. Maddesi, 1. Fıkrası, 35. Maddesi, 2. Fıkrası gereğince **30 Mart 2026 tarihinde (Pazartesi günü)** saat 10.00'dan başlayarak **"Beyaz Evde"** Prizren Belediye Meclisi oturum salonunda düzenlenecek olan Prizren Belediye Meclisin III./2026 (üçüncü) düzenli oturumu çağırıyorum. Belediye Meclisi üyesi niteliğinde işbu oturum çalışmaları için belirtilen saat, tarih ve yerde katılmanız üzere davetlisiniz:

İşbu toplantı için şu gündem noktaları belirlenmiştir.

GÜNDEM

1. 23 Ocak 2026 tarihli olağanüstü ve 17 Şubat 2026 tarihli resmi törenli toplantı tutanaklarının görüşülmesi ve onaylanması;
2. Gündemin görüşülmesi ve onaylanması;
3. Meclis üyelerin soruları ve çeşitli konuların dile getirilmesi;
4. Prizren Belediyesi Toplum Güvenlik Konseyi'nin kurulması ve bileşimine ilişkin teklif-kararın incelenmesi ve onaylanması;
5. "Zona e Pashtrikut" Derneğine mali kaynakların tahsisine ilişkin öneri kararın görüşülmesi ve onaylanması;
6. Prizren Belediyesi sınırları içindeki yolların, meydanların ve semtlerin adlandırılması için Komisyonun kurulmasına ve üyelerinin atanmasına ilişkin öneri kararın görüşülmesi ve onaylanması.
7. Prizren şehri sınırları içinde yapı ruhsatı, yıkım izni ve altyapı düzenleme ücretlerine ilişkin idari harcın ödenme yöntemine dair 02 Temmuz 2020 tarihli 001/011-60689 sayılı kararın iptaline ilişkin öneri kararın görüşülmesi ve onaylanması;
8. 29.05.2025 tarihli 001/011-68302 sayılı kararın değiştirilmesine ve tamamlanmasına ilişkin öneri kararın görüşülmesi ve onaylanması;
9. Yerel kurulların seçiminde saha çalışmalarının yürütülmesi ve koordinasyonu için Komisyonun atanmasına ilişkin öneri kararın görüşülmesi ve onaylanması;
10. Yerel kurulun seçim sürecine ilişkin şikâyetleri inceleyecek Komisyonun atanmasına dair öneri kararın görüşülmesi ve onaylanması;



Meclis Başkanı
Simir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Datë: 23 janar 2026.

Ora: 10:00.

Vendi: Salla për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në “Shtëpinë e Bardhë” - Prizren.

Në mbledhje morën pjesë këta anëtarë të Kuvendit të Komunës: Simir Krasniqi – Kryesues, Adem Shabanaj, Adrit Krasniqi, Agim Muqaj, Agnesa Sinanaj Gavazaj, Alban Bisliraj, Albulena Balaj Halimaj, Arianit Berisha, Bajram Kastrati, Dafina Alishani, Daut Panikaj, Dea Gavazaj, Drita Qenaj, Dzengis Saliji, Eldis Abazi, Endrit Zogaj, Haziz Hodaj, Ilir Gashi, Karanfil Haxhillari, Mergiton Gavazaj, Mimoza Memaj, Nazife Kokollari, Nerimane Pllana Gashi, Petrit Hoxhaj, Qemal Krasniqi, Sefidin Islamaj, Selman Sokolaj, Sevil Kazazi, Sevilja Igci Hapçi, Shqipe Shatri Çoçaj, Shukri Quni, Sulltan Badalli, Tefik Tarashaj, Trëndelina Kastrati, Ymran Fusha, Zikreta Aliti.

Munguan: Driton Sallauka, Zgjim Kryeziu, Liridona Veçgishti, Astrit Temaj.

Pjesëmarrës të tjerë ishin: Kryetari i Komunës z. Shaqir Totaj, Nënkryetari i Komunës z. Kujtim Gashi, Nënkryetari i Komunës për Komunitete z. Furkan Bütüçi, drejtorët e Drejtorive komunale, zyrtarë komunal, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe përfaqësues të mediumeve.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Simir Krasniqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ku dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Që jeni gati, fillojmë. Përshëndetje i nderuar kryetar i komunës zoti Shaqir Totaj, i nderuar nënkryetar Gashi, i nderuar nënkryetar për komunitete, zoti Butuç, përfaqësues të mediave, shoqërisë civile, të nderuar drejtor. I urojmë edhe pozitën drejtorit të ekonomisë dhe financave Levent Bushit. Urojmë suksese drejtor dhe punë të mbarë. Për sot, siç jeni njoftuar me kohë, kemi thirrur mbledhjen e jashtëzakonshme të kuvendit të komunës, bazuar në kërkesën e kryetarit të komunës. Të pranishëm jemi 33 anëtarë të kuvendit. Konstatojmë se kemi kuorum për me i vazhduar punimet e seancës. Para se të fillojmë me rendin e ditës që e kemi që e kemi për në këtë seancë ju informoj se zoti Florent Ukaj ka dhënë dorëheqjen nga anëtari i Kuvendit komunal. KQZ-ja ka marrë vendim për zëvendësimin e tij. Konsideroj që anëtari i ri i Kuvendit është prezent në sallë dhe pa humbur kohë do ta lexoj vendimin e KQZ-së dhe pastaj ftoj anëtarin e ri të Kuvendit që të bëjë betimin solemn para anëtarëve të Kuvendit. Në bazë të vendimit të KQZ-së me numër 01/75-2026 të datës 16.01.2026 për emërimin e anëtarit të kuvendit komunal zoti Bajram Kastrati emërohet anëtar i kuvendit komunal nga LDK-ja, duke e zëvendësuar zotin Florent Ukaj. Ftoj Bajram Kastrati të ngrihet në këmbë për dhënien e betimit dhe nënshkrimin e deklaratës së betimit. Betimi lexohet pjesë-pjesë nga unë, kryesuesi i kuvendit dhe përsëritet nga ju.

Bajram Kastrati: Unë, _____, “betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Simir Krasniqi (Kryesues): Urime pra Bajram. Atëherë pra siç ju informova dhe më herët për sot kemi thirrur mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës bazuar në kërkesën e Kryetarit të Komunës, me një pikë të vetme të rendit të ditës. Dhe kjo është:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim buxhetit të Komunës së Prizrenit për vitin 2026 dhe parashikimet për vitin 2027 dhe 2028.

Paraprakisht kjo pikë është shqyrtuar nga Komiteti për Politikë dhe Financa, rekomandimet nga Komiteti për Politikë dhe Financa i keni pranuar përmes e-mailit dhe në kopje fizike të gjithë kuvendarët këtu që jeni prezent. Atëherë, fillimisht ja japim fjalën drejtorit për ekonomi dhe financa. Për ju fjala, drejtor.

Levent Bus (Drejtor i Financave): I nderuar Kryetar i Komunës e Prizrenit, zoti Shaqir Totaj, i nderuar Kryesues, Nënkryetarët, të nderuar anëtarë të Kuvendit, kolegë drejtor, OJQ-të dhe ju mediat. Sot në rendit e ditës kemi shqyrtim të miratimit propozimit buxhetit të Komunës së Prizrenit për vitin 2026, si dhe parashikimet buxhetore për 2027 dhe 2028. Ky është një dokument me rëndësi të veçantë pasi përcakton drejtimet kryesore të zhvillimit ekonomik, social, institucional të Komunës sonë për vitet në vijim. Propozim buxheti është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, me prioritete strategjike të komunës dhe duke marrë parasysh nevojat reale të qytetarëve tonë. Ai synon në menaxhim të përgjithshëm të mjeteve publike, rritje të

transparencës, si dhe mbështetje të qëndrueshme për sektor kyç si arsimi, shëndetësia, infrastruktura, shërbime publike, administrative, shërbime sociale. Parashikimet për vitin 2027 dhe 2028 na japin pasqyrë të qartë për planifikimin afatmesëm dhe na ndihmojnë të sigurojmë vazhdimësi të projektit zhvillimore dhe stabilitet financiar për komunën tonë. Struktura e buxhetit për vitin 2026 është parapa kështu. Pagat me ditje 31.875.952 euro, mallrat e shërbime 14.500.234 euro, shpenzime komunale 1.069.493 euro, subvencione 5.521.785 euro, investime kapitale 22.577.849 euro. Kështu që me përqindje pagat në mediti i kemi 40.81%, mallrat e shërbimeve 19.32%, shpenzime komunale i kemi 1.43%, subvencione për sivjet i kemi 7.36% dhe investime kapitale i kemi 30.09%. Totali e buxhetit është parapa për vitin e 2026, 75.043.313 euro. Për sqarim më të detajuar që keni ndonjë pyetje, prezent është edhe zyrtari kryesor financiar, zoti Lulzim Sulejmani, kështu që po besoj që ky buxheti për 2026, anëtarë të Kuvendit votoni edhe vazhdojmë më tytje me punë për të mirën e Prizrenit. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. Ja japim fjalën shëfave të grupeve parlamentare të përfaqësuara këtu në kuvend. Së pari pra, shefi i grupit parlamentar nga Partia Demokratike e Kosovës, Arianit Berisha.

Arianit Berisha (PDK): I nderuar kryetar, të nderuar drejtor, të nderuar kolegë kuvendarë, përshëndetje të gjithëve. Thirrja ime si shef i grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës është që ta votojmë këtë buxhet. Ndoshta nuk është ky buxheti i hartuar më i miri që do të ekzistonte, por padyshim që është buxheti më i mirë i mundshëm duke parë parasysh rrethanat në të cilat është hartuar, duke parë parasysh ndërhyrjet që janë bërë gjatë vitit të kaluar nga detyrimet pra nga kontrata kolektive, borxhet, ta kemi parasysh që në këtë buxhet janë të përfshirë pothuajse çdo cep i Prizrenit, ka projekte të domosdoshme për jetën e qytetarëve e po besoj që këtu të gjithë jemi për me i shërby atyre, prandaj thirrja ime është që ta kalojmë këtë buxhet. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Arianit. Fjalën e ka shefja e grupit parlamentar nga Lëvizja Vetëvendosje Dafina Alishani.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesues, i përshëndes të gjithë anëtarët. Unë edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa e përsërita edhe për hir të korrektësisë ndaj qytetarëve dhe informimit ndaj qytetarëve. Konfirmimin ligjor nga MAPL, a e kemi për Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete. Këtë e kërkoja me shkrim, por ju u deklaruat që keni pasur kontakt me MAPL-në dhe keni pasur aprovim vetëm me gojë, por jo asesi me shkrim dhe duhet të presim afatet ligjore. Sa i përket komenteve lidhur me këtë buxhet, unë mendoj si grupi i Lëvizjes Vetëvendosje ne mendojmë që ky buxhet nuk e përfshin edhe nuk ka gjithëpërfshirje i krejt qytetit të Prizrenit. Është një fontanë dëshirash e këtij pushteti. Ne jemi të vetëdijshëm se si ka shkuar ky pushtet mandatin e kaluar dhe ky buxhet tregon edhe nijetin e këtij pushteti se si do të vazhdoj. Janë disa linja buxhetore të cilët janë vendosur aty, por pa mbulesë financiare vetëm e vetëm me pas emërime dhe me pasur një përkrahje nga anëtarë të caktuar të cilët vijnë nga ato lokalitete. Po ashtu në komitet unë kam kërkuar edhe borxhin total të komunës së Prizrenit. Nga zyrtari i financave u informohem që borxhi total është vetëm 9 milionë euro. Uroj që kjo është e

vërtetë edhe uroj që kjo është e saktë. Po ashtu, duke marrë parasysh që ka dhe shumë buxhet të cilët po shkojnë përmes përmbarimeve, qoftë me kontratë kolektive, qoftë përmes papërgjegjësive edhe të ministrisë apo vonesave të pagesave që është si rrjedhojë e këtyre kontratave kolektive. Mendoj që ky buxhet do të jetë prapë i mangët në aspekt të planifikimit, sepse ne po planifikojmë këtu buxhete të tërësishme të linjave të ndryshme, më pas kjo qeverisje pastaj nuk do të ketë aftësi me menaxhu për shkak që nuk është planifikuar edhe ashtu si është e duhur. Çështja tjetër që duhet dua ta ngrisë si shqetësim është kjo. Ju në seancën e kaluar të gjithë ju drejtorat nuk ishit të gatshëm as me u përgjigj në pyetje. Po dua me ditë a keni pasur ndonjë input në këtë buxhet apo vetëm i merrni buxhetin e drejtorave të kaluar, linjat e drejtorave të kaluar dhe a jeni të vetëdijshëm që jeni duke marrë një përgjegjësi dhe një barrë goxha të madhe? A ju ka pyetur dikush me thënë a ja del ose çfarë prioriteti ke ti si drejtor në drejtorinë tënde, pak a shumë, ju e dini çfarë mangësi kanë drejtoritë? I dini çfarë linja buxhetore kanë qenë të planifikuara dhe nuk janë realizuar? Pastaj ju do të jeni ata përgjegjës. Unë ju apeloj mbas një viti ju do të jeni ata të cilët do të kritikoheni që nuk keni mundur as me realizuar ose kanë mbetur suficit, ose nuk kanë mundur me u shpenzuar, sepse ky buxhet nuk është aspak real me kërkesat, me nevojat e qytetit edhe me mirëqenien e qytetarëve. Unë këtu po shoh shumë projekte të reja, të cilat pra po them që janë vendosur vetëm sa për sy e faqe. Ka ndërtim të qendrës kulturore, ju shumë mirë po ndërtoni objekte, po më pas a keni kode buxhetore ku mund t'i punësoni njerëzit në ato ndërtime të cilat po bëhen. Pastaj janë kode buxhetore shumë të përgjithësuara. Në secilën seancë ku diskutohet buxheti, kërkesën që ju bëjmë juve është a ka mundësi me i specifiku investimet? Këtu thotë ndërtimi i parqeve, ku janë ato parqe? Secili asambleist këtu duhet me pas parasysh këtë informatë që me ju monitoru juve dhe me kërkuar përgjegjësi nga secili prej juve që këtu e keni paraqitur si linje buxhetore. Po ashtu po e shohim që si prioritet qysh e keni pasur si qeverisje e kaluar me ble vetura, prap po e shoh që e keni parapa blerjen e veturave, ku i ke biçikletat kryetar? Pse s'po i mëson këta ekzekutivin me dalë me biçikletë, apo vetëm e ke për reklamë? Shtigjet për biçikleta është e vendosur këtu si projekt i ri edhe është i ndamë zero euro. Kjo tregon për këtë qeverisje. Kjo tregon për këtë makiazhin që e bën, për këtë Piarin-in që e bën ky kryetar, i cili thuhet që vjen me biçikletë, e parkon veturën midis qendrës. Ndërtimi i infrastrukturës në parkun ekonomik Lubizhd, 50.000 euro. A e di dikush me më tregu, çka mundemi me bë me 50.000 euro për zonën ekonomike? Për besë mo boz jemi bë edhe me biznese. Marre është më me diskutu zonën ekonomike ose me nda buxhete kaq të vogla. Kjo është mos seriozitet ndaj secilit biznes në Prizren. Ishte dasht, mbas këtij mandati, kjo qeverisje me urgjencë, me mbajtë një mbledhje dhe me pa se qysh mundemi me aktivizu këtë zonë ekonomike. Me 50.000 euro, sot i informoj të gjithë bizneset që ky kjo zonë ekonomike, ky park i biznesit nuk aktivizohet. Andaj ju informoj që kjo qeverisje nuk e ka prioritet aktivizimin e zonës ekonomike. Këto le ta dinë secili qytetar. Tanë vitin ne e kemi arsyetuar për për teleferikun, sot e shohim që ndërtimi i teleferikut në Kala ka vetëm 10.000 euro të ndara. A mund të na tregoni me 10.000 euro çfarë teleferiku parashihni me bë? Apo kryetari si sportist nuk e ka problem, thotë unë edhe me 10.000 euro e bëj ose eci për në Kala, po vetëm e vendos aty sa me i thënë qytetarëve që unë dua me realizuar projektin. Mendoj që edhe kjo nguti me seancë të jashtëzakonshme nuk është mirë as për kuvendart. Ishte dashur me pasur edhe një seancë ku

diskutohet prej prej secilit ë kuvendar, kërkesat e secilit kuvendar, sepse këtu i keni kuvendarët e rinj. Propozimet që ju arsyetoni me dëgjime publike ose me diskutimet që janë bërë në qeverisjen e kaluar, nuk kanë asnjë zë të asnjë asamblesit këtu, i kanë të vjetrit ndoshta, por ne kemi këtu shumë të rinj. Propozoj që ta keni një diskutim me kuvendin, qoftë me bë një dëgjim publik, qoftë me pasur kërkesa prej asambleistëve të cilët kanë dëshirë t'i japin, të diskutohet, të shterohet komplet diskutimi për buxhet, të bëhet një buxhet gjithëpërfshirës dhe pastaj ta sjellim në votim. Kjo nguti është tejet shqetësuese. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Dafin. Vazhdojmë me shefin e grupit të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Fjala për ju.

Haziz Hodaj (LDK): Ndoshta keni ndëgjuar çka ju thashë, ju përshëndeta! Ju përshëndes edhe drejtorët, anëtarët e kuvendit sigurisht, mediat këtu që po na përcjell me shumë vëmendje punën tonë. Unë edhe në seancën e kaluar e tërhoqa një vërejtje rreth hartimit të buxhetit. Realisht do të duhej me u konsultuar me të gjithë drejtorat që në fund të vitit, mos me na thënë drejtorët nuk kemi mundur me e realizuar sepse ka qenë një buxhet i aprovuar prej dikujt tjetër. Mirëpo, duke i marrë parasysh afatet që jemi në në fund të çdo afati për aprovimin të buxhetit. Ky buxhet do duhej me u aprovuar që në shtator të vitit të kaluar, mirëpo për shkaqe të njohura nuk ështëë aprovuar dhe na është lënë neve ta votojmë, ta miratojmë. E thashë edhe në Komitetin për Politikë e Financa, ka shumë mangësi, lënë për t'u dëshiruar si buxhet. Aq më tepër kur u informuam se në vitin e kaluar janë marrë nga përmbaruesi mbi 13 milionë euro dhe në anën tjetër ka borxhe komuna mbi 9 milionë euro për kompanitë të cilat kanë kryer ose janë në kryerje të të punimeve. Realisht në këtë vit nuk kemi buxhet dhe është dëshpruese që duhet të informojmë qytetarët se pak projekte apo hiç kanë me u realizuar brenda këtij viti, sepse kemi obligime nga viti i kaluar. Gjithsesi, ne do duhej apo duhet me hyrë prapë borxh në mënyrë që me evituar atë zbrazëtinë që e lënë ky buxhet këtë vit, mirëpo kjo mandej mbetet barrë edhe për buxhetin e vitit të ardhshëm. Thashë, jemi në afatet e fundit dhe sigurisht që duhet, ne e votojmë buxhetin për mos me blloku punën e ekzekutivit që ajo të vazhdojë në ecurinë e vet. Por mbasi jam këtu, kam edhe një kërkesë konkrete që do t'i lusja anëtarët e kuvendit ta votojnë, bëhet fjalë për një pozicion buxhetor të ri për hartimin e një projekti apo komosacion të mbi 100 hektarë tokë të bllokuara në Gjonaj kaher, është biseduar, kam biseduar edhe me autoritetet e hershme të komunës edhe në kohën e qeverisjes nga Vetëvendosja edhe nga legjislacioni i fundit nga kryetari Totaj. Mirëpo për mungesë të angazhimit apo edhe të mjeteve ka mbetur deri tani. Kështu që po kërkoj që këtë vit të bëhet hartimi i këtij projekti, komosacioni në fakt, i 100 hektarëve tokë, të zhbllokohen, sepse ka shumë nevojë, ka mbetur e bllokuar gjithë ajo hapësirë dhe njerëzit kanë nevojë edhe për troje, edhe për qasje në ato parcela. Unë i kam thirrur edhe qytetarët, edhe pronarët e asaj pjese që të jenë të disiplinuar dhe të japin kontributin e vet rreth hartimit të këtij projekti nesër, sepse bëhet fjalë për një pjesë e cila po shpresojmë që nesër do të jetë një lagje moderne dhe një rrugë alternative e fshatit Gjonaj, sepse ajo është më e madhi dhe ka, sigurisht që ka probleme rreth qarkullimit, rreth hyrjes edhe daljes. Mu tha se komuna ka një kontratë, me kompani konsulente për hartimin e projekteve, megjithatë me këmbëngulje po kërkoj një kod buxhetor, sepse është më obligativ dhe mund të realizohet

brenda këtij viti. Nuk do të duhej me qenë simbolik, minimumi 50.000 euro me i parapa që ky projekt të të finalizohet. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjalën e ka shefi i grupit nga Bashkimi Demokratik Shukri Quni.

Shukri Quni (BDP): Faleminderit kryesues, përshëndetje kryetar, kolegë kuvendarë, pranishëm, drejtorë, të nderuar qytetarë Prizrenit. Nëse dhe kemi këtë mbledhje të jashtëzakonshme, që s'ka qenë dashur me u bë e jashtëzakonshme, kjo ka qenë dashur me u kryer në shtator të 2025-ës. Po arsyet pse nuk është kryer aty i dini ju se më në fund ata kuvendarë që i kishit blerë ju lanë në baltë. Domethënë nuk ja mbajtën premtimin. E këtu tash kemi një ngarkesë për kuvendarët e rinj që s'kanë domethënë këta as aspak faj, por edhe drejtorët të cilët janë emëruar dhe këta nuk janë domethënë fajtorë për këtë. Se u dashtë me u ballafaqu me problemet të cilat po mendoj me kërkesat e qytetarëve në muajin shtator kur kishim votuar buxhetin për 2027. Dhe kjo nuk është barrë e tyre. Andaj, ky buxhet po shihet që ka shumë mangësi. Ka mangësi se nuk janë hyrë aty edhe ato kërkesat e qytetarëve që janë bërë nëpër debate, nëpër debate publike me qytetarët, e kam fjalën. Edhe është goxha një buxhet që është që anon vetëm nga elektorati juaj edhe nga njerëzit të cilët i keni simpatizantë të partisë. Domethënë në këtë buxhet fare nuk janë hyrë ose nuk janë marrë parasysh debatet që janë organizuar 2025. Këtu u tha që janë përfshirë të gjitha. Jo, nuk janë përfshirë të gjitha. Sepse kemi fshatra të cilat as nuk figurojnë në këtë projekt buxhet. Fshati Mazrek nuk figuron fare. Fshati Kujush poashtu. Planea po ashtu, Grozhupi figuron për riparimin e shkollës, po ajo është kryer 2025, se nuk e di pse është futur në 2026-ën ajo. Domethënë këto fshatra fare nuk janë parapa me infrastrukturë, kanalizime, ndërtim të rrugëve, trotuar, ndriçim publik, mure mbrojtëse, rrugë fushore e kështu me radhë. Edhe për këtë, nuk është mirë me thënë që është hartuar një projekt buxhet edhe i ka përfshirë të gjitha fshatrat e komunës Prizrenit. Se veç mundeni me i këqyr ju aty a figurojnë këta fshatra. Është fjala 2026, 2027 dhe 2028. Për tri vite është në pyetje. Bile në Planej është një rrugë, është rruga kryesore që shkon për në Gorozhup tash edhe për Shqipëri, bash te varrezat aty është shembur ajo rrugë. Drejtor veç kur të dëgjojmë ndonjë ditë që ka fluturuar dikush poshtë, aty ka nevojë për një mur mbrojtës, janë bërë shumë herë kërkesa për atë mur mbrojtës edhe nuk janë marrë parasysh fare. Pastaj janë futur disa kode, disa projekte të cilat nuk di çfarë të mire kanë qytetarët për to. Është një projekt nuk ka fare kod, për vitin 2026 janë ndarë 700.000 euro. Për vitin 2027, 800.000 euro, për vitin 2028, 1.000.000. Sa i bjen tash, sa mundi me llogarit tash unë këtu? Domethënë, diku mbi 2 milion e gjysmë sa i ra. Është për rehabilitimin e kanalizimit edhe për ujësjellës nëpër pjesë kryesore të qytetit. Unë sa e di që këto i ka detyrë me i kryer hidroregjioni jugor, përçka me ju dhënë mjetet atyre. Miliona me u nda për ta. Kur ata e kanë për detyrë se i marrin mjetet ata. Prej qytetarëve, sepse qytetarët i garanton ujë. Plus merr edhe taksën aty për kanalizim kur e bëjnë pagesën e ujit. Ku shkojnë ato mjetet? S'ka nevojë ne me nda këtu prej kuvendit mjete të tilla. Janë parapaku këtu, domethënë këto renovimet, rehabilitimet e kanalizimeve, ujësjellëseve. A unë e kam bërë një kërkesë për Nashec me u heq gypi i azbesit. Gypi i azbesit është dikun prej viteve 1972 në Nashec. Nuk është në gjendje me e vendos hidroregjioni një gyp, tani si janë këto plastike, sa çfarë janë këto gypa, me

u heq gypi i azbesit. Atëherë mjetet nuk ka nevojë me ju nda, se kanë mjete ata. Pastaj është një kod në Grazhdanik 200.000 euro. Po është vetëm për ndërtim domethënë për kanalizim edhe për për rrugë. Unë kërkesën e kam bërë, se unë jam kryetar i bashkësisë lokale atje, edhe për ndriçim publik, edhe për trotuar, edhe për mure mbrojtëse. Pastaj, një kërkesë që s'di sa herë në këtë kuvend e kam ripërsërit. Rregullimi i projektit për impiantin në fshatin Nashec. Mbi 50% të ujërave të zeza derdhen në fshatin Nashec, në Dri të Bardhë del. Sa emisione, sa televizionet, sa shkrimet janë bërë, kurrë nuk është marrë një hap i tillë, bile projektin me bë. E pastaj me kërkuar zgjidhje për për këtë projekt. Një investim është paraparë në fshatin Nashec, tek pushimoret, ju lutem kolegë kuvendarë të rinj, përcillni mirë. Ndërtimi i shtëpisë emergjente për mbrojtjen e fëmijëve në Nashec. Kodi 53610. 190.000 euro këtë vit, në 2026 me i nda. 230.000 euro në 2027, 150.000 euro në 2028, diku 570.000 euro. 570.000 euro janë para për tri vite. Kush nuk e di ku është pushimorja e Nashecit, unë ju tregoj. Ju si fëmijë kush janë të rinj, kanë shkuar atje. Po po flas prej pas luftës. Nuk di edhe këto, po ekzistojnë edhe procesverbalet edhe fjalët. Sa herë e kam ngritur si çështje, mos u investu në atë vend. Ka investuar ish-ministria e mirëqenies sociale, e kam fjalën, ka qenë atëherë, zëvendës-ministër Gjergj Dedaj, kanë hyrë aty 2-3 milion, sa kanë hyrë tash, nuk po e di. Në fakt, gjëja se kanë hyrë, se aty s'ka hyrë asnjë send, veç i kanë shkatërruar. Pastaj e ka marrë shoqata miqtë e TMK-së për me pushuar fëmijët e dëshmorëve, nja dy-tre vjet. Edhe aty goxha do farë teknike ka sjellë një shoqatë, KFOR-i zvicrian. Ç'ka është më e keqja, kur janë avulluar aty, makina të pa përdorura. Apo do përllamje të teshave. Po që e kam cekur edhe këtu, ka qenë një gjenerator që me kran tash s'po di qysh me i thënë asaj me vilushk për me i ngrit, se ai nuk ishte ngritur ndryshe. Me u pas qu na krejt Nasheci skishim mund me ngrit prej aty. S'është aty! Pastaj erdhi kryetar Mytaher Haskuka, edhe e bëni karantinë. Unë nuk kam reaguar atëherë si kuvendar. Mos investoni se nuk ka nevojë. Se boll kanë investuar. E zunën atëherë koxha më banën disa si po çoj pluhur e po kundërshtoj, e jo humanitare. Aty ish kanë pyetja dikush me ti grah mirë. S'ka nevojë me u kullit këtu, po ngoni çfarë po flas se për ju të rinjtë vlen kjo. Edhe aty mirë u investu, goxha mirë. Erdh në pushtet Partia Demokratike. Kryetarin e kam lutur për gjak, mos investo. Prap kanë investuar. Tash çka doni me ndërtu aty me këto 570.000 euro, 190.000 këtë këtë vit? Andaj mos e votoni këtë se ka me pas përgjegjësi dikush. Se këtu është duke shkuar mbulim pas mbulimit, keqpërdorimit edhe hajnit. Kam bërë dhe një kërkesë shumë herë për kanalizimin rruga Besim Shala. Drejtor, ajo lagje, lagja ... quhet pjesa më e madhe, ajo është lagja e jetës të zezë është ajo. Kanalizimi del përmbi rrugë, përmbi asfalt. Në ato gropat që ju mbushën, i fusin pumbën të dhe e gjuajnë në asfalt prej gropës, flliqësirë tash ta quaj atë. Kjo nuk është në rregull, shekulli 21 është. Me kerr kur të kalon një javë s'ti hiqet era kerrit. S'kanë ku të çojnë atë. Është goxha problem i madh ky. Ke qenë i njoftuar si drejtor i inspektoratit, po tash nuk e di sa jeni i njoftuar për këtë. Drejtorja e Arsimit ka paraparë renovimin e kulmit të shkollës Luigj Gurakuqi, në Nashec 45.000 euro. Unë e kam kërkuar me u ndërruar komplet. Renovimi ka pasur me u bërë 2024, hajde them 2025-ën po e ndërrojmë komplet, nuk e keni ndërruar, tash e keni lënë 2026-ën, prapë rinovim. Nuk pajtohem me këtë. Pastaj është parapa edhe ndërrimi i kalldajave. Janë ndërruar këto kalldajat? Tash nuk po e dijmë pse kanë hyrë tash këtu. Këto i kemi ndërruar. E shumë të tjera kam, se po e shoh që ka filluar pak me humbë edhe durimin te kolegët këtu. Po një send po ju

them, 75 milionë euro që tha drejtori për vitin 2026 që janë ndarë në këtë projekt buxhet, që për mua nuk është projekt buxhet, i ndan në mënyrë lineare për të gjithë. Edhe me ju dhënë disave, të cilët kanë dorë, kush e merr vesh çka është kanë dorë, tërë këto pare, qytetari nuk besoj që ka me ju besuar. Edhe unë jo. Bashkimi Demokratik nuk ka me votuar këtë projekt. Për arsyet që i dhash shumë prej këtyre, edhe për mosbesimin e atyre që tërë të pare me ju dhënë në dorë, nuk di çka bëjnë. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. E hapim debatin për anëtarët tjerë të kuvendit, kush do ta merr fjalën. Shqipe Shatri. Le të përgatitet Agim Muçaj.

Shqipe Shatri (LVV): Faleminderit i nderuar kryesues, zotëri Krasniqi. Përshëndetje të veçantë dhe për përfaqësuesin e drejtorisë së arsimit, zonjën Haxhere Gavazaj, kënaqësi sot që të kemi këtu. Të nderuar të pranishëm, për katër vite radhazi, Drejtoria Komunal e Arsimit e ka pasur të planifikuar si projekt kapital ndërtimin e sallës sportive në shkollën Mithat Frashri në Krajë. Kjo ka qenë kërkesë e kamotshme e drejtorisë së shkollës, e nxënësve dhe e prindërve të këtij fshati. Sot po konstatoj se në propozim-buxhetin për vitin 2026 ky projekt nuk figuron fare në listën e investimeve kapitale. Një projekt pra që mbahet për katër vite radhazi në planifikim, nuk mund të zhduket kështu pa asnjë sqarim. Prandaj kërkoj që ky projekt të rikthehet menjëherë në listën e investimeve kapitale të vitit 2026 dhe të përcaktohet një afat i menjëhershëm. Singërisht, si mundet me u fshij një projekt i arsimit kështu pa transparencë? I nderuar kryetar zotëri Totaj, pse ndërtimi i një qerdhe publike në Has nuk është askund në buxhetin 2026? Kjo ka qenë kërkesë e kahershme e qytetarëve të Hasit dhe e imja në vazhdimësi nga ky kuvend. Pres që ndërtimi i një qerdhe publike singërisht të merret me seriozitet dhe të përfshihet menjëherë në planifikimet buxhetore 2026. Gjithashtu dua të ndalem edhe të një çështje tjetër, gjendja e shkollës në fshatin Dedaj të Hasit. Kjo shkollë prej kohësh ka mungesë investimesh dhe kushte jo të përshtatshme për nxënësit. Prandaj kërkoj të përfshihet në planifikimin e investimeve kapitale, rrethimi i shkollës, të planifikohet renovimi i plotë i objektit dhe ndërtimi i një tereni sportiv për nxënësit e kësaj shkolle. Krejt në fund fare me keqardhje them se në planifikimet buxhetore për vitin 2026, shumë fshatra të Hasit kanë mbetur jashtë planifikimeve për investime kapitale. Duke e lënë kështu edhe njëherë Hasin fatkeqësisht në harresë. Faleminderit për vëmendje dhe mos transparencë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Shqipe, fjala për ju Agim Muçaj.

Agim Muçaj (AAK): Faleminderit kryesues, përshëndetje kryetar, ekzekutiv, të nderuar kolegë, media, qytetarë të nderuar. Unë dhe gjatë vitit të kaluar, gjatë dëgjimeve publike kam pasur vërejtje e mia dhe kërkesat e mia, mirëpo sigurisht edhe nuk janë marrë parasysh. Unë qysh edhe vitin e kaluar në dëgjimet publike ka potencuar se shumica e madhe e buxhetit është në vija të trasha dhe në nuk ka destinacion të një projekti të caktuar për shumën, vendin dhe se ku ka me u kry. Domethënë shumicën e rasteve ne nuk dimë se vetëm përmenden shifra, ato shifra për ne do të thotë janë të panjohura dhe për qytetarët gjithsesi janë të panjohura. Mirëpo këto sigurisht se ndoshta nuk kanë fuqi për t'i rregulluar. Kryetari i nderuar Totaj dhe i nderuar drejtor Islam Ukimeri. Ne e dimë që Korisha në zgjedhjet lokale ju ka nderuar dhe ju ka besuar me një sasi të

madhe të votave. Shumë mirë, me të vërtetë kanë pasur besim dhe ju kanë vlerësuar. Unë edhe gjatë mandatit të kaluar kam potencuar mbi dy herë këtu në këtë kuvend dhe në dëgjimet publike kam pasur një kërkesë të veçantë. Dhe ajo kërkesë është diçka shumë e rëndësishme për jetën njerëzore të gjithë banorët e fshatit Korish, çka do të thotë për ujin e pijes. E kam potencuar se shumë vite më herët nga komuna është filluar një projekt dhe i cili nuk ka përfunduar deri në fund asnjëherë. Dhe kam potencuar që përafërsisht me rreth 200.000 euro, Korisha mund ta rregullon problemin e ujit të pijes së paku për një dekadë apo për dy. Dhe kisha dashur që këtë vit sezonin e verës ta presëm me një stabilitet të ujit të pijes dhe ky është një mesazh nga Korisha që ngarkojnë gjatë këtij viti mundësisht, do të thotë se nuk është ndonjë shumë që nuk mund ta bëjë apo nuk mund ta tejkalojë kuvendi i komunës. Dhe me urgjencë kisha kërkuar që të hapet një kod apo të gjendet mënyra se si të rregullohet problemi i ujit të pijes, që të funksionalizohet bazena të lartë. Islam, ti shumë mirë je i njohur për këtë problem. Dhe pasi që je edhe vendas, nga banorët e Korishës, kërkojnë që gjatë sezonës së verës të kemi ujë mjaft, atëherë kur vjen edhe diaspora, na sigurisht nga thatësira humb fuqia e ujit të bazenit dhe rritet shpenzimi dhe konsumi i banorëve, kështu që e kisha kërkuar që me urgjencë së paku këtë kërkesë e kam veçantë pa u shtrë në kërkesat tjera edhe pse ka vrejtet e mia të mjaftueshme. Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Agim. Fjalën e ka Sevilya Hapçi. Le të përgatitet Petrit Hoxhaj.

Sevilya Hapçi (KDTP): Sayın Belediye Başkanı, Belediye Başkan yardımcıları, meclis Başkanı, Müdürlerimiz, meclis üyelerimiz, basın mensuplarımız ve bizleri izleyen değerli Prizrenli halkımız, hepinizi saygıyla selamlıyorum. KDTP meclis üyesi olarak bugünkü gündem ile ilgili 2 önerim ve bir sorum olacak. Öncelikle Türk toplumu için son derece önemli olan Türk Kültür Merkezi binası hakkında söze başlayacağım.

Hepimizin bildiği üzere, Türk Kültür Merkezi binamızın dış cephe ve yapısal inşaatı büyük ölçüde tamamlanmıştır. Bu aşamadan sonra binanın gerçek anlamda işlev kazanabilmesi için iç mekân düzenlemeleri, teknik donanımı ve kullanım altyapısının tamamlanması gerekmektedir. Ancak 2026 yılı bütçesinde Türk Kültür Merkezi için yalnızca 50.000 avro ayrılmıştır. Açıkça ifade etmek isterim ki; bu tutar, binanın içyapısının tamamlanması için yeterli değildir. İç mekân çalışmaları: -elektrik ve aydınlatma sistemleri, ses düzenlemeler, sahne ve oturma alanları, ısıtma, havalandırma ve teknik altyapı gibi yüksek maliyetli ve uzmanlık gerektiren işleri kapsamaktadır. Bu kadar kapsamlı bir iç donanımın 50.000 avro ile tamamlanması mümkün değildir.

Burada şunu özellikle vurgulamak isterim: Türk Kültür Merkezi; sadece Türkler için değil, Prizrenimiz için, ençlerimiz için bir eğitim alanı, sanatçılarımız için bir üretim mekânı, derneklerimiz ve topluluklarımız için bir buluşma noktasıdır.

Bu nedenle, bu binayı yarım bırakmak Prizren'in kültürel geleceğini ertelemek anlamına gelir.

Bu gerekçelerle; 2026 yılı bütçesinde Kültür Merkezi için ayrılan 50.000 avroluk ödeneğin 200.000 avro artırılmasını, Sayın Belediye Başkanımızda Shaqir Totaj ve ilgili birimlerden yeniden değerlendirilmesini talep ediyorum. Bu artış, bir gider değil; Prizren'in kültürüne, gençliğine ve geleceğine yapılan bir yatırımdır. İkinci önerim ise Kamu hizmetlerinin 13. Noktasında yer alan

birçok mahalle ve yerleşimde taşlı yolların, kaldırımların ve meydanların restorasyon ve inşası için yeni projeye rr. Tirana mahallesinde (interex-galleria) kadar olan tretuvarların da restorasyonlarının eklenmesini talep ediyorum. Sorum: Subvensiyonlara ayrılan bütçede Üniversite öğrencilerine burslar yer alıyor mu? Yer alıyorsa bir artış var mı? Saygılarımla teşekkür ederim.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Sevilya, fjala për ju, Petrit Hoxhaj.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, të nderuar drejtor kuvendor, shoqëri civile, media dhe ju qytetarë të nderuar. Që sot secili prej neve kuvendarët kemi pranë buxhetin apo projekt buxhetin për vitin 2026-28, ku komuna ka paraparë investimeve saja në qytetin e Prizrenit. Prej investimeve të reja janë të parapara me diku 38 kode buxhetore apo projekte të reja, por për habi apo për çudi nuk është parapër as të një fshat i pjesës së Vrrinit. Nëse hyjmë, do thotë, i analizojmë secilën. Në Vërmicë nuk ka asnjë investim i parapam. Në Shkoz, Dobrusht, Billush, Hoq, Poslisht, ku kryetari i vet i fshatit Poslisht është njëri prej kryetarëve më aktiv që ka marrë pjesë për secilin ftesë që është bërë nga Kuvendi dhe ka bërë kërkesa të ndryshme dhe për çudi nuk është e parapam me asnjë kërkesë për për fshatin Poslisht. Ndërsa për fshatin Zhur është i parapam me renovimi i shkollës së vjetër. Zhuri nuk e meriton, nuk e nuk i takon ta ketë një objekt të vjetër të shkollës sepse objekti i vjetër përpos që muret janë të plot myk dhe erë e keqe që i vjen brenda, për çdo një vjet ose dy vjet ndahen në buxhet për renovim të kësaj shkolle. Zhuri e meriton një shkollë më të mirë, një objekt më të pastër dhe më të ngrohtë për fëmijët e tyre. Po ashtu në fshatin Muradem kanë qenë të pranuar disa investime prej komunës, murin mbrojtës që është i domosdoshëm për të parandaluar ndonjë fatkeqësi natyrore që mund të ndodhë dhe nuk është sot në kodin buxhetor. Po ashtu në fshatin Kobaj është i paraparë me diku 250.000, mirëpo kjo është borxhi të cilët kompanitë e kanë lënë në gjendje të mjerueshme rrugët në brendësi të fshatit dhe të fshatit të vjetër Kobajit. Ndërsa ka dhe shumë fshatra të tjera të cilat nuk janë parapa, do thotë në kod dhe nuk mundet me dalë shefi i grupit të PDK-së me thënë që është një buxhet i përfshirë për të gjithë anët dhe fshatrat. Përkundrazi, është një buxhet i prerë me gërshtë në të gjitha lokalitetet që i ka ky kuvend. Kaq për këtë buxhet dhe unë do të jem kundër këtij buxheti. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Petrit. Fjalën e ka Eldi Abazi. Ne të përgatitet Zikreta Aliti.

Eldis Abazi:

Zikreta Aliti:

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju, Mergiton Gavazaj.

Mergiton Gavazaj (LVV): Faleminderit kryesues. Përshëndetje për të gjithë. Dua të ndalem te propozim buxheti, të mënyra se si është trajtuar fshati Zhur. Në drejtorinë e shërbimeve publike, e cila drejtori me buxhetin më të madh në komunë, në këtë drejtori Zhuri është përfshirë vetëm në

disa punime, si rehabilitimi i rrugëve, rehabilitimi i kanalizimit dhe ujësjellësit, vendosja e ujëmbajtësve dhe shenjëzimi horizontal dhe vertikal. Këto janë të nevojshme, por janë minimale për një fshat të madh si Zhuri. Në të njëjtën propozim buxheti Zhuri nuk është përmendur në projekte si rregullimi i mureve mbrojtëse, mbi mbajtja e ndriçimit publik, ku sot rreth 80% e fshatit është në errësirë. Si dhe finalizimi i stadiumit të Zhurit, ku ka mbetur i papërfunduar. Po ashtu në drejtorinë e emergjencës dhe sigurisë, nuk është parashikuar funksionalizimi i brigadës së zjarrfikësve, edhe pse objekti është i gatshëm dhe do t'i shërbente të gjithë fshatarëve përreth. Në drejtorinë e kulturës mungon funksionalizimi dhe finalizimi i shtëpisë së kulturës, një objekt i rëndësishëm për jetën kulturore të fshatit, i cili vazhdon të mbetet jashtë vëmendjes buxhetore. Të gjitha këto tregojnë se Zhuri, nuk është trajtuar me seriozitet në këtë propozim buxhet. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjala për ju zonja Nerimane.

Nerimane Pllana Gashi (LVV): Të nderuar të pranishëm dhe qytetarë të Prizrenit, desha të ndalem te Drejtoria e Shërbimeve Publike pika 24, ku ceket instalimi i ndriçimit publik për disa lagje të qytetit, e që lagjja Dardania nuk është përfshirë fare. Rruga Ukë Bytyçi nga rrethi i Bashdarhanës deri te rrethi i Tranzitit të ri paraqet vështirësi për lëvizje dhe jo siguri gjatë orëve të mbrëmjes. Mbi pesë shtylla i keni të dëmtuara. Ndërsa pjesa tjetër e shtyllave nuk funksionon fare. Si dhe brenda lagjes Dardania, vendosja dhe mirëmbajtja e ndriçimit adekuat do të ndikonte drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë dhe cilësisë së jetës së banorëve të kësaj lagjeje. Mandej desha të kaloj te Drejtoria e Shëndetësisë, pika numër 7, ku theksohet instalimi dhe montimi i ngrohjes qendrore dhe klimatizimi eficient në objektet shëndetësore. Desha të di më konkretisht se për cilat objekte është fokusi. Dhe të bëj kërkesë që të futet edhe AMF-ja në Jaglenicë, pasi që ngrohja aty është shumë e dobët, ende bëhet me dru dhe me stufë. Te drejtoria e Kulturës, pika numër 11, ku ceket ndërtimi i parqeve rekreative në disa lagje të qytetit, e ndër këto dhe lagja Dardania është e përfshime. A mund të di më konkretisht për cilën pjesë të lagjes bëhet fjalë, çfarë hapësirash rekreative dhe sportive do të përfshihen, si dhe a do të kenë qasje personat me nevoja të veçanta? Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjala për ju Sefidin Islamaj.

Sefidin Islamaj (BDP): Faleminderit zoti kryesues. Përshëndetje i nderuar kryetar i komunës zotëri Shaqir Totaj, të nderuar kolegë asambleistë, të nderuar bashkëqytetarë të Prizrenit, ju përshëndes me respekt. Na keni mbledhur sot për shqyrtimin e projekt buxhetit të komunës së Prizrenit që për mua në pamje të parë duket si punim seminarik i studentëve të vitit të parë në fakultetin ekonomik, sesa një projekt buxheti i detajuar se ku do të shkojnë paratë e qytetarëve të Prizrenit. I pa detajuar, i pandarë qartë edhe sipas llojit të financimit dhe kategorive të shpenzimeve, gjë e cila tregon dukshëm mungesën e profesionalizmit. Pse sot jam kundër këtij propozim buxheti. Në hyrje të këtij projekti buxheti, kryetari i drejtohet qytetarëve si projekt i zhvillimit ekonomik, ku sipas prioriteteve ju siguron dhe investitorëve ambient të sigurtë dhe tërheqës për investimet dhe ngritjen e mirëqenies sociale të qytetarëve të Prizrenit me 137 projekte.

Ama në këtë projekt buxhet, në asnjë pikë të tij nuk ka dhe nuk parasheh një plan-program në mënyrë që të përdoret për të tërhequr investitorët dhe për zhvillimin ekonomik. Tjetër, në këtë projekt buxhet përmend përmirësimin shpejt, i gjendjes ekonomike shoqërore të banorëve të komunës. Me cilin nga këto projekte që keni shënuar më sipër mund të arrihet kjo? Do isha lutur hartuesit të këtij projekti buxheti në foltore që do thotë që filan projekt këtu do të përmirësojë gjendjen ekonomike të qytetarëve të Prizrenit dhe cila pikë e këtij projekti buxheti ju mundëson qytetarëve të Prizrenit që në vitin 2026 të do kenë një ekonomi më të mirë? Sepse, nëse s'gabo, në drejtorinë e zhvillimit ekonomik dhe turizmit, përkundër rritjes së buxhetit, meqënëse po pretendohet zhvillimi ekonomik, jemi rast unik që në buxhet është ulur krahasuar me atë paraprak, ku në vitin 2025 paska patur mbi 625.000 euro buxhet, kurse në atë që parashihet në vitin 2026 ka rënë 400.000 euro. Dhe është i mangët në drejtim të mirëqenjes sociale. A nuk janë rregullimi i mirëqenjes sociale, heqja e fëmijëve lypsarë nga semaforët? A nuk është rregullimi i mirëqenjes sociale, ata familje që jetojnë në zonat rurale, në fshatrat, ku për fëmijët e tyre për shkollimin e mesëm paguajnë bilete të autobusave deri në 2 euro, vetëm për një drejtim. A nuk përfshihet në politikat sociale banorët e fshatit Poslisht, të lagjes së re, quajtur lagje te mollat dhe atyre banorëve të Hoçës së Qytetit, të lagjes së Gashve dhe Bytyqve, që janë mbi 70 shtëpi, akoma me gropa septike, që kërkesën e tyre për ndërtimin e kanalizimit, për herë të parë pranë komunës e paskan dorëzuar në vitin 2018. Pastaj për herë të dytë në vitin 2022, prapë në vitin 2022, 2024 dhe nuk është futur në projekt buxhet të vitit 2026 dhe nuk parashihet as në vitin 2027 dhe në vitin 2028. A nuk përfshihet në politika dhe mirëqenies sociale të banorët e fshatit Billush, që për 25 vite rresht trokasën dyerve të komunës, organizatave dhe hidroregjionit jugor me kërkesë të vetme bazike uj. Edhe ky projekt nuk është paraparë në vitin 2026 dhe nuk parashihet as në vitin 2027 dhe në atë të vitit 2028. Nuk është futur në këtë projekt buxhet as rruga që lidh Hoqen e Qytetit të vendit të ashtuquajtur Te kullat në drejtim të fshatit Poslisht që lidh me rrugën kryesore këto dy fshatra. Një projekt shumë i rëndësishëm sidomos për fshatin Poslisht do të kontribuojë në ngritjen e zhvillimit ekonomik, por dhe çasjen më të lehtë të vizitorëve të huaj dhe atyre lokalë që vijnë drejt Poslishtit. Si mundet një nga sektorët më të rëndësishme të zhvillimit ekonomik të qytetit, drejtorisë së bujqësisë, i ndahen vetëm 400.000 euro, ku ka vetëm katër (4) projekte të paraparura në këtë projekt buxhet. Dy prej të cilave nuk lidhen fare me drejtorinë e bujqësisë. Për shembull, ndërtimi i strejmore për qent endacak, ç'ka të bëjë me çfarë ka të bëjë ky projekt me bujqësinë. Ky projekt, ku më përpara duhet të trajtoheshin, qentë endacak nga drejtoria e shërbimeve publike për nga problematika. Do kisha pasur dëshirë që pas meje të merrte fjalën drejtori i bujqësisë, të na thotë çfarë objektiva drejtoria e bujqësisë do të ketë në vitin 2026, me 400.000 euro buxhet, ku në komunën e Prizrenit janë të regjistruar 1.300 fermerë. Si ka mundësi që të votohet një buxhet prej 137 projekteve të propozuar, ku në këtë projekt buxhet 18 prej tyre në këtë listë nuk ndahet asnjë cent në vitin 2026. Si mund të votohet një buxhet, ku si kategori e ndarjes së buxheteve që na është propozuar, që na ka ardhur materiali edhe neve, janë propozuar 5.521.000 euro si kategori vetëm subvencione dhe nuk ceket se si dhe ku do të ndahen këto subvencione. Si mund të besohet një buxhet prej 2.500.000 euro një drejtuesi të një drejtorie që pritet të përballet përpara organeve të drejtësisë për manipulim të votave. Pastaj, në drejtorinë e emergjencave nuk parashihet një

buxhet i ndarë enkas për fatkeqësi. Si duhet t'i kompensojmë këto familje që janë prekur nga vërshimet e fundit? Unë si asambleist i Bashkimit Demokratik bazuar në këto fakte që përmenda më sipër dhe në ndarjen e padrejtë të buxhetit, nuk kam asnjë arsye t'i besoj këtë buxhet. Një subjekti që së bashku me partnerët e koalicionit tyre kanë manipuluar vullnetin e qytetarëve. Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjalën e ka Selman Sokoli.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesues. Para se me hy te çështja e buxhetit, sinqerisht po mungon edhe një burrë aty në krahun tuaj të majtë kryesus, edhe të kompletohet ky mozaiku i burrave në rendin e parë Qysh ka thënë lideri juaj, nuk e di, ka ju më special kështu me gota me qelq, këta të tjerët e të gjithë ne me gota të plastikës. Po kjo po tregon edhe njëherë për mendësinë e qeverisjes së kryetarit Totaj, e cila është shprehur kështu në mënyrë brutale në emërimin e drejtorëve dhe drejtoreshave nëse mundemi me gjet aty këtu. Tash po hyj te buxheti. Pra, ky buxhet që sot na paraqitet nuk është buxhet në shërbim të qytetarëve, por buxhet i klaneve dhe grupeve të interesit. Është një dokument që reflekton keqplanifikim, keqklasifikim dhe vazhdimësi të drejtpërdrejtë të keq qeverisjes së katërvjeçarit të kaluar nga Partia në Pushtet dhe kryetari Shaqir Totaj. Ky buxhet nuk bazohet në një vizion zhvillimor, as në planet të qarta e projekte të mirëfillta. Përkundrazi kemi punë pa plan, projektet e nisura të lënë përgjysmë, investimet të koduara jo për zhvillim, por për të mbuluar borxhet ose me saktë fajdet në të cilat na ka futur komuna e Prizrenit e udhëhequr nga Shaqir Totaj, neve këtu dhe të gjithë qytetarët e komunës e Prizrenit si taksapagues. Ky buxhet përveç të tjerash i anashkalon edhe sektorët më të rëndësishëm duke ndarë shuma qesharake, për shembull, për bujqësinë, shëndetësinë, turizmin, zhvillimin ekonomik dhe çështjet sociale. Mirëpo kjo nuk është rastësi. Ajo dëshmon paaftësi serioze në planifikim dhe menaxhim financiar, si dhe një kaos të plotë në qeverisjen buxhetore. Dhe kjo paaftësi nuk është e re. Kjo paaftësi ka shkaktuar miliona euro borxhe. E njëjta qasje e Shaqir Totajt është parë edhe më herët gjatë angazhimit e tij në ATK, Administratën tatimore të Kosovës, ku performanca në mbledhjen e të hyrave sa ky ka qenë aty drejtor, ka qenë shumë e dobët. Kjo është parë edhe në klubin basketbollistik Bashkimi, ku janë lënë borxhe të konsiderueshme që kanë lënë pasojë afatgjate për atë klub. Pra, ajo që sot ne kemi para vetes, është vetëm një konfirmim i paaftësisë menaxheriale, tashmë e dëshmuar, e cila sot po i kushton drejtpërdrejtë qytetit dhe qytetarëve të komunës së Prizrenit. Totaj iki, sigurisht avazi i vjetër, nuk ka durim a guxim a si ta quajmë me ndenjtë në seancë, kjo tregon dobësinë e tij si kryetar, si pushtetar. Mirëpo unë kështu po e pyes publikisht mbase na shikon në televizion ose shikon më vonë, çka ka ky person me Gjonajt? Sinqerisht nuk e kuptoj çka ja ka marrë inati Gjonajt. Ka pesë vite që flitet për rrugën e Gjonajt dhe prapë në këtë buxhet rruga e Gjonajt nuk është e planifikuar në një kod që tregon qartë projekt, mjete të ndara edhe fillim të punimeve për rehabilitim total të asaj rruge për shkak që siç jemi tashmë dëshmitarë, siç jemi në dijeni të gjithë, ajo rrugë është në gjendje të mjerueshme. Në këtë buxhet është paraparë edhe ndërtimi i stadiumit në Gjonaj. A nuk e keni prerë shiritin e atij stadiumi? Mbase aq sa e dinë qytetarët e komunës së Prizrenit bashkë me ish-kryetarin e ish-deputetin, tashmë as kryetar, as deputet, Memli Krasniqin, ju e keni prerë

shiritin, Shaqir Totaj me drejtorët e tij, me partiak, bashkëpartiakët e tij, e ka prerë shiritin e stadiumit në Gjonaj. Tash po del se paskan harruar diçka, paskan harruar me ndërtuar shkallët, ulëset. Mbase mbas katër viteve me vazhder ky avazi i duhen dekada të tona me kompletu një projekt që kishte mundur me qenë shumë projekt i thjeshtë, nëse ishte planifikuar mirë edhe nëse ishin ndarë mjetet e nevojshme në një periudhë kohore që parashihet qartë dhe që e parasheh atë projekt në detaje. E kemi një përrua në Romajnë. Auditori ka gjetur shkelje në atë projekt. Janë ndarë pak mjete në vitet e mëhershme, kosto është shumë e lartë. As ai përrua që është ndërtuar për 4 vite 300 m, as 100 m për një vit, edhe aty është një shtyllë e tensionit të lartë e cila po rrezikohet për shkak të gërmimeve që i ka bërë komuna Prizrenit dhe drejtori i shërbimeve publike duhet me qenë vigjilent për shkak se aty edhe kryetari i komunës së Prizrenit si zyrtar kryesor administrativ, i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen e punëve dhe zbatimin e ligjshmërisë në komunën Prizrenit, duhet me qenë vigjilent, edhe kështu publikisht po ja tërheq vërejtjen se nëse ndodh aty një fatkeqësi, nëse atyre banorëve i ndodh një fatkeqësi për shkak se shtylla e tensionit të lartë, është e rrezikuar për shkak të gërmimeve, po e them edhe një herë, atëherë ju do të jepni llogari para qytetarëve politike po se po, mirëpo edhe para ligjit për neglizhencë edhe mosveprim. E kemi edhe stadiumin Has Arena. Kur keni ardhur në pushtet në vitin 2021, keni premtuar që do ta përfundoni brenda tri viteve. Ashtu në kornizën afatmesme buxhetore 2022-2025, keni premtuar këtu që do t'i ndani secilin vit nga 1 milion euro dhe në vitin 2025 ai projekt do të jetë i harruar. Aty ka vetëm kubëza edhe asfalt apo beton. Sigurisht aty duket që më shumë është një projekt i shërbimeve publike, se i drejtorisë së sporteve. Edhe aty keni vazhduar prapë me ndarje qesharake të buxheteve. Domethënë, kryesus të gjitha këto që i ceka më lart, janë improvizime të komunës së Prizrenit, e udhëhequr nga Partia Demokratike dhe kryetari Shaqir Totaj. Kështu që ne nuk kemi arsye as më të vogël që ta mbështesim dhe ta votojmë këtë buxhet. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjalën e ka Alban Bislimaj. Ne të përgatitet Ilir Gashi.

Alban Bislimaj (PDK): Faleminderit kryesues, të nderuar nënkryetar, ekzekutiv, kuvendar, qytetar, media. Andaj për dallim për kolegët që morën fjalën deri më tani, të gjithë patën kundërshtimin në lidhjen me buxhetin, unë e kam të kundërtën. Më la përshtypje një koleg kuvendar i cili foli, pasi veç po folim secili për regjionin e vet. Ai po fol për Hasin, për Vrrinin. Më la përshtypje Petriti që foli për projektet e Kobajt të Vllajshës. Veç ndoshta ta informoj domethënë opinionin që nuk është ashtu qysh po flet Petriti, pasi që Kobaj e ka një projekt në vazhdimësi është 250.000 euro dhe ai projekt ka qenë vitit të kaluar dhe ai ka qenë diku 335.000 euro dhe janë të përfshira të gjitha rrugët e fshatit. Domethënë nuk ka rrugë që s'është e përfshirë. Ndriçimi është kryer, përmendi edhe rrugën për Kobajn e Vjetër. Ai projekt domethënëdo të shkon me projektin korniz, pasi që kompania e cila ka qenë është ndërpreh kontrata për disa arsye. Edhe ai projekt domethënë do të shkon në projekt korniz, ka mbetur domethënë veç shtresa e asfaltit. Përndryshe edhe Vllashnja unë shoh që ka projekte aty, ka kanalizim, ka ujësjellës. Është e parapanë që në ato fshatra të bëhet edhe sinjalizimi horizontal, pasi që vitin e kaluar ka qenë i parapanë qyteti, tash po shoh që shumë sinjalizime do të bëhen edhe nëpër fshatra. Kaq kisha domethënë një reagim, një keqinformim që ju bëhet qytetarëve, unë dashta me reagu që nuk është

ashtu, sepse jo çdokush e këqyr projektin, po i këqyr këto videot edhe mendon që është e saktë ajo që thotë kolegu kuvendar. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Alban. Fjala për ju Ilir Gashi.

Ilir Gashi (LVV): Faleminderit zotëri kryesues. Para se t'ia nisi do të ishte mirë ndoshta Graniti apo dikush me thirr kryetarin me ardh me u kthi në vend të vetin. Fundi i fundit është një seancë e thirrur prej kryetarit. Ja ku e kemi letrën, është kërkesë dhe thirrje, ftesë prej kryetarit që kuvendarët takohen në një seancë të jashtëzakonshme për me trajtuar këtë dokument që e ka përpiluar vetë kryetari, që është dokumenti më i rëndësishëm i komunës që duhet me u votuar nga ky kuvend, nga këta anëtarë, e tash vetë me ik. Mos ti thell tash me analizuar karakterin e s'di çka tjetër, le t'i mbetet nder atij, ai qysh mendon, po aspak nuk është në rregull që me e bë këtë send. Si kryetar i komunës, ai do të duhej të dilte në foltore, ta bënte një ekspozitë edhe me tregu, ja, ky është buxhet komunal, paraja publike, që unë me ekipin tim e kemi hartuar, edhe me treguar, për katër vite është punuar kjo, kemi ardhur në këtë pikë, ndërsa për katër vitet e ardhshme me këtë buxhet nga pika A do të mbrijmë në pikën B dhe jeta e qytetarëve do të bëhet më e mirë, më komode, do të kemi zhvillim andej, e do të kemi zhvillim këndeje dhe të na bëjnë neve që ta votojmë këtë dokument. Po mbas ai nuk e murrë fjalën edhe duke e parë se qysh janë klasifikuar këto projekte, lind një dyshim që kryetari nuk ka aspak dorë në këtë buxhet. Sepse për me pasur dorë duhet me pasur vizion. Ai nuk ka vizion. Ai nuk ka pasur as premtime gjatë fushatës elektorale. Me gjasë, ky është fontanë dëshirash të pazareve politike që kanë bërë me grupacione të ndryshme të interesit. E kur dalin fituesit e tenderave, atëherë marrin vesh se cili projekt kujt i shërben këtu. Klasifikimi, emërtimi i projekteve është shumë i paqartë. Po filloj nga e para, projekte ambientale në qytet. Çka i bjen projekt ambiental? Presim përgjigje pastaj prej drejtorit. Ndërtimi i rrugës tranzitore numër 14, numër rendor. Kryqëzimi me autostradën në Prizren, projekt dy vjeçar shpronësimi i tokave. Shumë e paqartë. Shiko, po thotë projekt dyvjeçar, për këtë vit janë ndarë 100.000 euro, po për vitin që vjen 0 euro, për vitin e tretë 200.000 euro. Ku është logjika që është projekt dyvjeçar? Ndërtimi i infrastrukturës në Tusuz, shpronësimi i tokave, për çfarë lloj ndërtim infrastrukturor do të jetë? A janë rrugë, a janë objekte, çka janë? Çka do të shpronësohet? Prona private, për çfarë qëllime, çka janë këto shuma, a janë mjaftueshme do të thotë, për çfarë sipërfaqe do të bëhet shpronësim? Drejtor, nuk po të ngushtojmë me definicione, çka është rehabilitim dhe revitalizim i hapësirave publike në zonën e parë të mbrojtur në pjesën e vjetër të qytetit. Ky emërtim është ndërruar për zonën e mbrojtur, nuk është më. Është qendër historike. Restaurimi i shesheve dhe objekteve. Sa sheshe janë aty në qendrën historike? A mundesh me i numëruar? Sa sheshe janë? Cilat kanë me u restauruar edhe cilat objekte? Veç t'ju përkujtoj se me 2014-ën është investuar minimum 500-600.000 euro në sheshin e lidhjes. E tash i nda mbi 3.000.000 për sheshin Shadërvan. Ku do të investoni më këto pare? Ku e keni paraqitur këtë projekt më së pari njëherë? Katër vite jemi kemi qenë zhytur në në terr. Dardania, Bajram Curi, Arbana, Jeta e Re, Bashdarhanja. E tash keni nda buxhet vetëm për këtë vit 685.000 euro, ndërsa për dy vitet e ardhshme edhe 2.1 milion euro. Instalimi i ndriçimit. A thua aty nuk ka fare ndriçim që keni me instaluar tash, apo ekziston, keni me bë ndonjë ndryshim? Nëse është ndryshim, pse kjo shumë

kaq marramense? Vetëm vitin e kaluar i keni ngjyrosur që ato shtylla elektrike që s'kanë bërë dritë, po janë ngjyrosur. E sivjet, çka planifikoni me bërë? Edhe për vitin e ardhshëm, edhe mbas saj. 2.8 milionë euro i keni nda për tre vite. Teleferiku e përmendën, 10.000 euro. A janë për projekt? Hartimin e projektit? A janë për studim fizibiliteti? Këto shuma të tjera janë shumë minimale për dy vitet e ardhshme. Cila është dinamika e punimeve? Qysh mendoni me e përfundu? Apo vetëm me i hedh pluhur syve të popullit, me krijuar përshtypje se po punon diçka. Në turizëm, drejtor, Prizreni që mburremi se është qyteti i turizmit dhe turizmi po kthehet në një industri për gjenerimin, për zhvillim ekonomik, i keni ndarë vetëm 400.000 euro edhe shikoni cilat projekte i keni ndarë 400.000 euro. Me ato projekte, çfarë zhvillimi mund të arrijmë? Asnjë projekt për promovimin e turizmit, për masovizimin, për ngritjen e kapaciteteve, asnjë projekt për rritjen e turistëve dhe rritjen e netëve që ata duhet t'i kalojnë sa më shumë këtu. Qëllimi kryesor të turistit është me pru turistin edhe me e mbajtë sa më gjatë. Asnjë projekt në atë drejtim, ndërsa mburremi se jemi qytet i turizmit dhe kemi shpresa për zhvillim ekonomik nga industria e turizmit. Në drejtorinë e arsimit është një projekt. Dixhitalizimi i sistemit të institucioneve arsimore në shkollat, dy pika dhe vazhdon Emin Duraku, Mati Logoroci e të plotë të tjerë. Çka i bjen kjo? A mund dikush me përkthi në gjuhën tonë të kuptueshme? Shiko, digjitalizimi i sistemit të institucioneve arsimore në shkollat. Çka është shkolla, çka është institucioni arsimor? A kanë dallim mes veti? Çfarë doni me me digjitalizu? Cilin sistem? Sistemin e menaxhimit të stafit, sistemin e menaxhimit të vlerësimit të nxënësve, sistemin e menaxhimit të inventarit, apo ka ndonjë sistem diçka tjetër? Apo mos ndoshta e pashë që në drejtori të arsimit nuk kishit parapa projekte të kota që një zotëri i njohur për trika i fitonte çdo vjet, mos eventualisht edhe këtu ka gisht trikaxhiu, 120.000 euro, sa ishin ndame, për dy vite gati 200.000 e kusur euro. Veç po më lindë dyshimet nga e kaluara. Edhe disa projekte ishin të paqarta në drejtorinë e Kulturës, ishin këto hapësirat rekreative Bashdarhane te katër kullat. Ku ka aty hapësirë, cila hapësirë është komunale, publike, që ju doni me bërë qendër rekreative, kur përballë vetëm 100 m tutje është qendra sportive me të gjitha hapësirat përcjellëse dhe të mjaftueshme. Vendosja e tribunave teleskopike në qendrën sportive, qendra sportive është një kompleks i madh. Ku mendoni ato me i vendos, në cilën sallë, për çfarë lloj eventesh do të përdoren, apo mos vallë edhe këto projekte janë me porosi që pastaj individë dhe kompani të caktuara të fitojnë tender për pajisje që kurrë apo për investime që kurrë nuk na hyjnë në punë. Faleminderit për dëgjim.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Ilir, fjala për ju Karanfil Haxhillari.

Karanfil Haxhillari (LVV): Faleminderit kryesues, të nderuar koleg kuvendar, qytetar të dashur të Prizrenit. Kryesus paraprakisht e kam një vërejtje sepse në çdo seancë paraprakisht, pavarësisht që është seancë e jashtëzakonshme, hedhet në votim pika e rendit të ditës, ku kuvendarët e votojnë si pikë të rendit të ditës. Kësaj radhe nuk u hodh në votim. Dhe tani po kalojmë në diskutimin për buxhet. Ky buxhet i cili po na prezantohet sot është 100% i njëjtë sikurse buxheti i cili na u prezantua në shtator të vitit 2025, ku aso kohe i njëjti buxhet nuk i pat votat edhe korumin, kurse sot për të njëjtin buxhet bëhet thirrje për votim. Le të mbetet tek qytetarët e Prizrenit me vlerësu. Në bazë të pasqyrës kodeve buxhetore gjithsej i kemi 137 kode buxhetore, vetëm 36 janë projekte

të reja. Pra të gjithë të tjerat janë vazhdimësi të kodeve buxhetore. Dhe nga 16 kode buxhetore në vitin 2026, po për këtë vit janë zero euro të ndame. Pra ky buxhet i cili po na prezantohet na bjen që u tha janë 9 milionë borxhe e që aspak nuk është e vërtetë. Besoj që ja keni heq një zero e janë 90 milionë euro borxhe. E që ky keq planifikim dhe keq klasifikim i këtij buxheti, jam i sigurt që do ta thelloj borxhin e komunës së Prizrenit edhe ashtu nga këto taksapagues të cilët po kontribuojnë dhe nuk po ja shohin hajrin në asnjë moment. Po dua t'i cek, neve e kemi pasur edhe në kornizën afatmesme buxhetore dhe po dua tatash të flas për komunitetin që e përfaqësoj. Ka qenë kodi buxhetor ndërtimi i rrugës Struzh-Qafë Kushnini. Dhe ai kod buxhetor ka filluar punën dhe është shtruar 1.2 km, por që kanë mbetur edhe 8 km të tjerë pa shtruar. Dhe që tani më nuk parashihet në asnjë kod buxhetor, pra është hequr fare si projekt ky kod buxhetor rruga Struzh-Stanet e Struzhës. Po ashtu në lagjen Petrov. Sikurse katër vitet e kaluara me zero cent edhe katër vitet të tjera, të nderuar Petrovali, po ashtu zero cent do të jetë nga kjo qeverisje. Në të gjitha kodet buxhetore shihet qartë se nuk është përfshirë as edhe një premtim elektorale, qoftë i kaluar para katër vite, por edhe ndonjë aty këtu, sepse u tha që s'ka pas premtime, që i bjen që edhe për katër vitet të ardhshme do të jetë avazi i vjetër. Të nderuar qytetarë të komunës së Prizrenit, ky buxhet është thjesht një buxhet për interesa të ngushta, klanore, ky buxhet nuk parasheh zhvillimin e komunës së Prizrenit, ky buxhet thjesht është kopje paste i buxhetit të vitit të kaluar, por që i ka ra hise drejtorave të cilët tashmë të rinj a do të munden me i realizuar apo jo dhe sipas kësaj e po e potencoj që borxhi do të jetë edhe më lart. Edhe në fund, 75 milionë euro buxhet t'i besohet disa drejtorëve të ekzekutivit, të cilët në zgjedhjet e fundit me mijëra vota tjetërsuan vullnetin qytetar, imagjinoni se çfarë do të bëjnë me këtë buxhet për katër vitet e ardhshme. Deri tash, po vlojnë rrjetet sociale se çfarë po ndodh në komunën e Prizrenit dhe deri tash asnjani nuk e merr përgjegjësinë, bile edhe s'paska ardhur një zonjë e nderuar, për me dhënë përgjegjësi për të gjithë këtë kaos të cilën është krijuar në komunën e Prizrenit. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Ka diskutues të tjerë? Petrit fjala për ju është.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Kryesues, mu përmend emri, nuk e mora menjëherë, shkak për hirë të respektit të kuvendarëve të tjerë që ta përfundojnë. Zotëri Albani e përmendi që ka investime edhe në fshatin Kobaj. Është e vërtetë që kanë filluar. Mirëpo shumë është interesant që çështja e asfaltit të Kobit të vjetër, qysh ka mbetur në gjysmë dhe ky projekt lyp hetim, sepse ka filluar gabimisht keq dhe ka përfunduar keq. Qëkjo është esenca që mos t'i bëjmë projektet pa mjete financiare, pa kode buxhetare. Ndërsa ndriçimi publik e përmendi, mirëpo mos t'ia bëjmë prapë sikur në kohën e Enver Hoxhës që është vendosur një dritë në një fshat dhe është ndriçuar fshati. Ka pjesë shumë të fshatit Kobani të cilët janë në terr dhe lyp mbi investime të më tutjeshme. Deshte apo s'deshte si Albani dhe Tefiki, unë jam kryetar i këtyre dyve, kështu që duhet me pas mirëkuptim. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Petrit, fjalën e ka Albani.

Alban Bislimaj (PDK): Masi ma përmendi emrin edhe njëherë po ndërlidhena. Kështu që ky po i di sendet më mirë se unë që banoj aty. Dhe ky mund të jetë kryetar, por unë jam banor i Kobajt.

Normalisht që ndriçimi publik ka me vazhdu, sepse janë disa lagje apo disa shtëpi që s'kanë shtylla elektrike dhe aty tash do të jetë një projekt tjetër që të vendosen shtylla, përndryshe aty ku ka pasur shtyllë të rrymës, domethënë aty gjithmonë është vendosur edhe ndriçimi publik. Unë e përmenda dhe parës për Kobajn e Vjetër është në kornizë, kontratë kornizë, kështu që edhe ajo punë ka me kryer, ti merre me votime, çka duash bën veç kjo punë ka me kry.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Alban. Kemi diskutime tjera nga anëtarët e kuvendit. Po fjala për ju Arianit Berisha.

Arianit Berisha (PDK): Fillimisht kam pranuar një kërkesë nga udhëheqësi i shërbimeve publike për disa ndryshime brenda pozicioneve, ata janë kompetent për këtë çështje edhe besoj që domethënë nuk i kalon kufijtë e drejtorisë, nuk i kalon kufijtë e kodeve, por janë vetëm ndryshime brenda pozicioneve. Këtë kërkesë të shkruar do ta dorëzoj posa ta përfundoj fjalën kryesues. Dhe meqënëse edhe mua më është përmend emri, fatmirësisht në demokraci se cili kemi të drejtë me e thënë mendimin tonë, unë s'paska të drejtë me thënë që buxheti është i mirë, por koha ka me treguar që buxheti është i mirë, madje pikërisht kolegu që më ka përmendur emrin, ka me u lavduar me këto projekte, po jo në asamble, në facebook, mirëpo ne duhet me qenë të njëjtë edhe në asamble, edhe në facebook, edhe në jetë, edhe me qytetarët. Ndërsa për të gjithë kuvendarët e opozitës që preokupim shumica prej tyre i kanë borxhet. Në një anë i kanë preokupim borxhet, ndërsa në anën tjetër nuk duan me kuptuar që në këto projekte janë të përfshira ato borxhe. Gjatë gjithë fushatës na kanë akuzuar që s'kemi punuar, sot na akuzojnë që i kemi rritur borxhet, që i bjen është bëra punë e madhe, janë bërë projekte të mëdhaja. Në mbledhjen e kalume u tha që pse nuk po përgjigjen drejtorët kur të gjitha pyetjet ishin nevoja të qytetarëve për këto projekte, këto shkolla, këto qerdhe, këto kanalizime, këto drita. A janë këto projekte dhe a janë këto nevoja të qytetarëve? Këtë pyetje besoj që duhet t'ia bëni veten dhe nëse e keni preokupim qytetarin, atëherë duheni me votu këtë buxhet se po i lëmë pa asnjë shërbim nëse s'e kalojmë këtë buxhet. Është një obsesion me u marrë me kryetarin Totaj, me e përmend vazhdimisht, por zgjedhjet janë kryer bre! Me këtë qasje të juajen, ju fatkeqësisht jeni zvogëlu si parti. Edhe unë mendoj që ju duheni me pas një qasje, me ardh me projekte konkrete e jo me retorikë boshe dhe ato projekte unë do të jem i pari që do t'jua votoj. Mirëpo po vazhdon kjo qasje e njëjtë, ndoshta në aspektin politik na konvenon, mirëpo qytetarëve të Prizrenit kjo qasje e juaja nuk i konvenon. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Arianit. S'ju ka përmendur emri Dafina, si shef i grupit atëherë mund ta jap fjalën.

Dafina Alishani (LVV): Emër nuk ka nevojë me përmendur sepse nëse drejtohet tek grupi i asambleistëve të Lëvizjes atëherë edhe neve na duhet me kthi një përgjigje. Pikë së pari opozita jemi ne, nëse nuk e dini. Epo mirë ne jemi opozita edhe në emër të opozitës tash ndëgjoni. Në një nuk e kuptova rekomandimin e shefit të grupit të PDK-së në emër të kujt dha një kërkesë. Apo i bie që as me grupin e PDK-së nuk keni diskutuar buxhetin e vitit të ardhshëm? Apo i bie? Po qysh jo? A s'po takoheni? Tash keni gjetur këtu me i dhënë rekomandimet e drejtorisë përkatëse me limite. E para. E dyta, ne këtu vazhdimisht kemi thënë se ka keq klasifikim, ka keq menaxhim edhe

kjo çdo vit na është treguar neve me shifra. Keni pasur buxhet të tmerrshëm, keni pasur mbetje të tmerrshme, ky kryetar i cili ka thënë që jam menaxher i hatashëm, ka pasur rekord të suficitit çdo vit. Diku u ankuar që ka kredi komuna ose ka një marrëveshje, diku është ankuar herë prej drejtorive, diku ka heshtur. Mu për këtë arsye unë po ju bëj edhe njëherë thirrje këtyre drejtorave. Mbas një viti qeky kryetar ka me hesht, ju keni me dhënë përgjegjësinë në këtë buxhet. Andaj sot e merrni personale ju që juve po ju akuzojmë, po besoni që shumë lehtë heq dorë PDK-ja kur është çështja me ik prej përgjegjësisë. Normal që na e kritikojmë kryetarin Totaj. A e di pse? Se komplet ky ekzekutiv i raporton kryetarit. Komplet ky ekzekutiv duhet me me i tregu kryetarit çfarë planifikimi ka, çfarë objektiva ka, çfarë orientimi ka. Edhe komplet ky buxhet është orientim i kryetarit. Andaj normal që ne mirremi me kryetarin. Po problemi është që kryetari nuk po mirret me kuvendin. Nuk ka guxim me ndeji, me na dëgju. Nuk ka guxim as kritikave me ju kundërpërgjigj. Pse është kuvendi? Pse na bëni thirrje? Edhe pse po na mbledhni nëse njëmend nuk keni nevojë ju për kuvendin? Pavarësisht që i keni numrat. Kjo është arrogancë e pushtetit. Unë ju kam bërë thirrje me seancën të parë, kam thënë, ju si drejtor të ri edhe si qeverisje e re, keni mundësi me bashkëpunu me legjislativin. Keni mundësi me pas gjithëpërfshirje. Tash nëse kryetari del prej sallës kur opozita e merr fjalën, me kë me u marr unë i nderuar? Nëse kryetari nuk përgjigjet në asnjë linjë buxhetore me na tregu neve çfarë orientimi ka me pas ky qytet për katër vitet të ardhshme, ose për vitin e ardhshëm meqë po flitet buxheti. Nëse asnjë drejtor nuk ka asnjë sqarim për asnjë pyetje të asamblistëve. Asnjë kërkesë e cila është thirrë... qe prapë. A po shihni që me start ky kryetar e tregon qasjen ndaj legjislativit. Edhe për fund, rregullojeni atë karrikë se na tranojnë me atë zhurmë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Përmbaju rregullores së Kuvendit.

Dafina Alishani (LVV): Po po rregullorja s'është respektuar sot tërë ditën. Tërë ditën nuk është respektuar minutazha. Sot mbasi po kritikoj tash kryetarin paskeni filluar avazin e vjetër me ndal fjalë kur kritikohet kryetari. Bëhuni bre më demokratik se jeni Partia Demokratike. Ndëgjoni kritikën, ka kohë që s'jemi takuar, proceduralisht e kemi mbajtur një seancë të kaluar, ndëgjoni kritikën, se qeky buxhet ka me ju hëngër kokën juve vitin e ardhshëm. Ky buxhet nuk duhet me u votuar. Ky buxhet nuk ka gjithëpërfshirje. Ky buxhet nuk i ka as bazën esenciale për mirëqënien e qytetarëve, të cilët shumë, edhe ju e dini shumë mirë që ka shumë mungesa. Është buxhet klientelist, Zoti ju ndihmoftë juve drejtorave të rinj që po ju japin këtë buxhet kështu. Uroj që nuk keni me dalë faqe zezë, po qysh po e shoh unë me këtë trend ju e dini shumë mirë, sidomos ish-kolegët tanë, e dinë shumë mirë çfarë linja buxhetore, cilët drejtorë ju kanë lënë. Domethënë, uroj mos të jeni kukull në ato pozita edhe uroj që sinqerisht dalni faqe bardhë. Ne si Lëvizje Vetëvendosje nuk marrim pjesë as në votim këtij buxheti. Kritikën tonë i kemi thënë. Arsyeja pse jemi në këtë takim është me informu qytetarët se çka bën kjo qeverisje me fillim të mandatit dhe çfarë orientimi ka kjo qeverisje. Urime juve që i pasket numrat edhe inshallah ja shihni hajrin këtij buxheti, por neve na keni këtu bashkë me kritikë, bashkë me monitorim të cilën e kemi obligim nga qytetarët e Prizrenit. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Vazhdojmë, kemi diskutime të tjera nga anëtarët e kuvendit? Po, Shukri Quni.

Shukri Quni (BDP): Faleminderit kryesues. Nuk është vetëm Vetëvendosja, opozita. Ne kemi grup parlamentar. Edhe secili ka parimet e veta edhe planet edhe ato që i ka paraqitur para elektoratit. Për atë kemi ardhur ne këtu. Me kritiku, me kërkua me hy në projekt buxhet. Po unë, më i vjetër po e them atë, e di që keni respekt pjesa dërmuese, sidomos ju gjenerata e re, e ardhmja e shtetit. Që unë e besoj shumë në ju. Po e ndiej veten mirë që thashë jam në mesin e shumë të rinjëve. Po është mirë disa sugjerime. Po edhe vërejtje me marrë nuk është keq. Ju si kuvendar sidomos, që ju ka pruar qytetari, me e mbrojtë të drejtën e qytetarit. Jo të drejtat klanore ose grupe, se keni me u pendu. Pastaj ju drejtorët që keni marrë punë, ngarkesë, përgjegjësi. Se ne ju shohim krejtëm përballë, edhe kur ne flasim me ju qeshni me ironi, na të gjithë i shohim. Të jeni shumë të kujdesshëm. Edhe lëvizjet që i bëni me duar, se këtu kamera të gjitha na këqyrin. Të jeni shumë të kujdesshëm, po ju jap këshilla sikur me qenë.. po them nxënësia të mi, mos të them fëmijët të mi. Shumë të kujdesshëm me qenë. Andaj kryeni këtë detyrë që ju ka dhënë qytetari, me nder, me respekt. Dëgjoni kur flasin kuvendarët. Mos i nënçmoni se keni me mësu shumë prej tyre. Edhe kur nuk flasim nganjëherë mirë që s'po ja qëllojmë, ju keni me marrë mësim. Dëgjoni kërkesat e kuvendarëve që bëhen. Edhe ne kuvendarët, sidomos ju të rinjtë me qenë kombëngulës në kërkesat e juaja. Mos pajtohem me vendimet të cilat nuk janë në të mirë të qytetarit edhe e dini mirë që nuk është në interesin e qytetarit, kushdo qoftë. Hazizi është më i vjetër këtu, në kuvend, unë jam mandej. Unë s'jam pajtuar edhe me ish-kryetar përpara, mos hi tash me i cek se nuk është në rregull. E kam fjalën kur nuk e kanë pasur mirë. Edhe me kryesues qashtu, kryesues që je tash e kemi marrë këtë detyrë, ta kemi dhënë një votë, të kemi pasur edhe me një vakt shef të grupit. Ajo ana andej, që s'jam ulur unë asnjëherë, shumë shpejt, mos ta foli ndonjë fjalë pak me banal, por shumë shpejt koka aty ndryshon. Kur të ulin në ato karrige. Çdo vërejtje, sugjerime që i bën, i bën, ne i japim asnjë në interes personal. Për interes personal i kemi pasur mandatin e kaluar, e ceka dhe më herët, pse nuk është votuar qeky buxhet? Ata kuvendorë të cilët i futën.. edhe këtu tash mo të hyj, se i kam thënë shumë herë, ata i lënë baltë. Nuk ja votuan buxhetin. Ky buxhet s'ka pasur nevojë sot me ardhë këtu. Edhe ne me u ballafaqu me këta. Ky ka qenë dashur me u votue në shtator. As ju me pas këtë barrë, as ne si kuvendarë. Me u marrë me punë të tjera, kemi punë. E kështu që respektoni opozitën. Unë e shumë herë kam qenë edhe opozitë, brenda pozitës, kam kritikuar se kam pasur atë dert, prapë se kam, kam me dhënë kritika, vërejtje aty ku e shoh që nuk është duke shku në rregull. Andaj, mos se keni me pendu disa për disa veprime që keni me i bë. Sikurse që po ju shoh që jeni penduar në shumë raste. Ku jeni ju djem në atë anë andej, unë jam kanë i ulen. Para jush! Kur është themeluar ky kuvend. Djem dhe vajza në përgjithësi po flas. Nuk jam pajtuar me vendimet të cilat janë marrë vendime jo të drejta për qytetarët. Edhe për atë, koxha gati jam këtu. S'ka mundur me më thy asnjë interes i jemi personal. Prap s'ka me mund! Mbasi i kam bërë këto vjet besoj që nuk lakmoj. Po mbroni, ngoni mirë çka po flasin kolegët këtu në falltore. Çka po kërkohet? Secili i kërkon ata edhe në çështje kombëtare mos harroni. Ky kuvend i ka rrënjët në gjak e kam përmendur shumë herë. Ky ka qenë, do ta përmendi prapë se këta të rinjtë nuk e kanë dëgjuar. A e dini çfarë ka qenë kjo? Kjo ka qenë shtëpia e armatës Jugosllavisë.

Kush se ka ditë. Më ka ra me përmend shumë herë me cek, se shtëpina e armatës Jugosllave e ka shndërruar profesor doktor Eqrem Kryeziu në kuvend me ardhë me folë ju këtu. Mos e keq përdorni. Qaty drejtorët veç një po e shoh dy që kanë qenë mandatin e kaluar. Po edhe këndej në asamble, nga kuvendi. Edhe këtu nuk janë kush e disa që kanë qenë mandatet e kaluara. Kryeni me nder se keni me u pendu, po ju tregoj. Ju të rinjët sidomos, mos bëhuni vegël, po mbron votën e qytetarit ai qytetar që ju ka sjellë këtu. Jam ndër të parët që kam reaguar me 1 janar vota ime, se shumë herë kam pas koxha do farë kritika. Unë më duket të fola për qetë që duhet me na ndëgju. Unë shumë e dëgjoj, secili kur flet, kurse, kur nuk mundem dal jashtë. Koxha është qu pluhur, bile disa dhe u tallën, a gjete votën? Po po kam me gjetur. E kam gjetur. Vota është sendi më i besueshëm. Jo me ble, jo me vjedh, po ai që ta qet në zemër, mbroja sepse e ke obligim e mbrojtë atë. Edhe këtu jeni për me i mbrojtë interesat e qytetarëve. Qatë ditë që kanë me ju kryni punë juve. Ata kanë me ju mbajtë, kanë me thënë ju kemi në... Unë po ju tregoj që deri sot nuk ka arritur kush me mbajtë në... As e kam atë dert fare hiç. E di që pak dola prej temës, po kanë me ju vytë këto farë sugjerime. Faleminderit që ju dëgjuat.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Atëherë vazhdojmë me përgjigjet e drejtorëve, ata që kanë përgjigje, që nuk kanë drejtorat, mund ta hedhim në votim. Mirë, atëherë e hedhim në votim.

Haziz Hodaj (LDK): Kryesues, më fal. Pata një propozim konkret. Po veç njëherë duhet të qaj propozimi e mandej buxheti mu aprovu.

Simir Krasniqi (Kryesues): Para se ta hedhim në votim me rekomandimet e shefit të grupit parlamentar për ndryshime të disa pozicioneve brenda për brenda buxhetit edhe kërkesa juaj rekomandimi juaj që të futet në buxhet. E hedhim në votim që të inkorporojmë pra në buxhet këto rekomandimet e juaja. Në sallë jemi 25. Kush është për? 20 për. Kundër? 5 kundër. Abstenim? Abstenim nuk ka. Atëherë futen në projektbuxhet këto propozimet e juaja që të inkorporohen në buxhetin e vitit 2026.

Atëherë, e hedhim në tërësi pra me propozimet e inkorporuara që u votuan këtu. Kush është për miratimin e buxhetit me ndryshimet e këtyre siç u votua më herët. 26 janë prezent. Për? 21 për. Kundër? 5 kundër. Abstenim nuk ka. Atëherë miratohet buxheti komunës së Prizrenit për 2026. Ju faleminderit për pjesëmarrjen dhe këtu e mbyllim seancën. Shihemi në seancat e radhës.

**Kryesuesi i Kuvendit
Simir Krasniqi**



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PROCESVERBALI

Nga mbledhja e Solemne e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 17.02.2026, duke filluar nga ora 09:00, në sallën për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Ftesa për këtë mbledhje ishte për nderë të 18 vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Mbledhja u hap me Himnin Kombëtar Shqiptar dhe Himnin e Republikës së Kosovës.

Mbledhja u kryesua nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z. Simir Krasniqi.

Simir Krasniqi (Kryesues): Të dashur qytetarë të komunës së Prizrenit, shumë të nderuar familje të dëshmorëve, të nderuar invalidë, veteranë të luftës së ushtrisë çlirimtare të Kosovës, shumë i nderuar kryetar i komunës zoti Shaqir Totaj, nënkryetar për komunitete zoti Furkan Bytyç, të nderuar anëtarë të kuvendit, drejtorët e ekzekutivit, i nderuar deputet zoti Gashi, të nderuar përfaqësues nga konsolata Turke, përfaqësues nga FSK-ja, përfaqësues nga Policia, Kfori Turk, i nderuar rektori i Universitetit të Prizrenit zoti Alishani, të nderuar drejtorit i QKMF-së, të nderuar përfaqësues të komunitetit Fetar, përfaqësues të bizneseve, shoqërisë civile, media, të nderuar të pranishëm. Mirë se keni ardhur në seancën solemne të ftuar për nder të 17 shkurtit ditës së pavarësisë së Kosovës. Në nderim të gjithë dëshmorëve dhe të rëndëve për liri ju ftoj për një minutë heshtje. Lavdi!

Kam nderin dhe kënaqësinë që sot të hap këtë seancë solemne, një prej ngjarjeve më të rëndësishme në historinë tonë kombëtare, shpalljen e pavarësisë së Republikës së Kosovës. 17 shkurti i vitit 2008 shënoi një epokë të re, realizimi i aspiratave shekullore për popullin e Kosovës, për liri, demokraci dhe shtet të pavarur. Kjo është një ditë historike, një ditë që na kujton sakrificat, mundin dhe përpjekjet e mëdha të brezave të tërë, për lirinë dhe shtetësinë e Kosovës. Pavarësia e Kosovës është fryt i sakrificës së dëshmorëve, martirëve, të luftës heroike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe mbështetjes së aleatëve tonë ndërkombëtarë në rrugëtimin tonë për liri dhe pavarësi. Derisa ne të gjithë po e festojmë këtë ditë, po e zbeh mos prezenca e liri bërësve dhe atyre që shpallen pavarësinë tonë, të cilët padrejtësisht po përballen në gjykatën speciale me akuza

të pabaza. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakub Krasniqi, Rexhep Selimi e të tjerë. Lusim që drejtësia të triumfoi dhe çlirimtarët të shpallen të pafajshëm. Sot më shumë se kurrë na duhet unitet dhe përkushtim për ta bërë Kosovën një vend ku rinia ka perspektivë, ku sundon ligji dhe ku secili ndihet krenar për shtetin e tij. Të festojmë këtë ditë me krenari dhe të vazhdojmë të punojmë së bashku për një Kosovë më të fortë, më të zhvilluar, duke ruajtur lirinë dhe duke ndërtuar një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët tanë. Gëzuar përjetësisht pavarësia e Kosovës. Lavdi dëshmorëve, nderim të përjetshëm luftëtarëve të lirisë. Ju faleminderit.

Në këtë seancë solemne kemi nderin që tani të dëgjojmë përfaqësuesit nga subjektet politike me urimet dhe mesazhet e tyre. E fillojmë me përfaqësuesin nga Partia Demokratike e Kosovës.

Arianit Berisha (PDK): Të nderuar familjarë të dëshmorëve, invalidë e veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. I nderuar kryetar, nënkryetar, kabinet i drejtorëve, i nderuar kryesues, kolegë kuvendar, të nderuar përfaqësues të policisë dhe ushtrisë Kosovës, përfaqësues të bashkësive fetare, i nderuar deputet, i nderuar rektor, të nderuar media dhe ju të pranishëm. Ky përvjetor i pavarësisë, për dallim nga vitet tjera ku zakonisht mbizotëron festa dhe gëzimi, sot na gjen të thyer emocionalisht. Por ashtu si në vitet e luftës kur sa më e madhe ishte forca e agresorit, aq më e madhe ishte edhe rezistenca e këtij populli, ashtu edhe ky përvjetor do të mbahet mend gjatë për krenarinë që ndjejmë secili prej nesh, si kundërpërgjigje ndaj atyre që po tentojnë ta ndryshojnë rrjedhën e historisë dhe ndaj atyre që po u bëhen krah. E për të ardhur deri te pavarësia e deri te kjo ditë e sotme, dikush dha gjithçka, dikush dha vetëm diçka, e shumë kush nuk dha asgjë. Shumë prej nesh sot besoj ëndërrojmë që të kishim mundësinë që të paktën një ditë të vetme të kishim qenë pjesë e ushtrisë së lavdishme çlirimtare. Por një gjë e tillë është e pamundur. Ai kapitull është përmbyllur dhe do të mbetet në histori si epoka më e lavdishme e kombit shqiptar. Ndoshta sot ushtarët të UÇK-së nuk mund të bëhemi dot. Për ushtarët të Kosovës po. Secili nga pozicioni ynë të japim kontribut të vlefshëm që ta forcojmë shtetin e Kosovës, për të cilin u bënë shumë sakrifica e u derdh shumë gjak. Ata që po mundohen të na dëmtojnë, sot na kanë dhënë një mundësi të ardhur që ta bëjmë këtë gjë, por edhe që të bëhemi argat të UÇK-së, duke i mbrojtur vlerat e luftës si më e pakta gjë që mund të bëjmë. Po e shfrytëzoj këtë foltore për t'ju bërë thirrje të gjithëve pa përjashtim, që t'i bashkohemi sot protestës “drejtësi jo politikë”. Sot të gjithë e kemi rastin të jemi UÇK, duke i treguar botës që jemi të bashkuar dhe nuk ka bindje politike që na ndan. Nëse dikur nuk kemi qenë pjesë e luftës për arsye të ndryshme, të dalim sot dhe t'i nderojmë, e t'i respektojmë ata që sakrifkuan çdo gjë që sot të kemi mundësinë të flasim e të jetojmë të lirë. Uroj që në përvjetorin e ardhshëm të pavarësisë, Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakub Krasniqin, Rexhep Selimin, Salim Mustafën e çlirimtarët të tjerë t'i kemi në mesin tonë. Po e përmbyll këtë fjalim me disa vargje të xhaxhait tim, heroit të Kosovës, profesorit Xhemajli Berisha, të cilat më kanë frymëzuar vazhdimisht. “Lirinë nuk e meritojnë qyqarët, as frikacakët. Kush nuk derdh një pikë gjak për tokën të vet, kush nuk jep asnjë qindarkë për të, ai s'ka të drejtë as të varroset në të”. Urime pavarësia, ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Ju faleminderit Arianit. E ftojme përfaqësuesin nga Lëvizja Vetëvendosje.

Karanfil Haxhillari (LVV): I nderuari kryesues, i nderuari kryetar i komunës, të nderuar përfaqësues të familjeve dëshmorëve, përfaqësues nga shoqata të dalura nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, përfaqësues nga ushtria nga policia, nga Kfor-i, përfaqësues nga komuniteti fetar, i nderuari rektor i UPZ-së, të nderuar mysafirë, të pranishëm, koleg kuvendar, të dashur qytetarë të komunës sonë. Sot është një ditë që na zgjon kujtesën, na forcon shpirtin dhe na mbush zemrën me krenari. Sot shënojmë 18-vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, 18 vite shtet. Në 17 shkurt 2008, u dëgjua zëri i një populli që për dekada kishte duruar padrejtësi, por kurrë nuk ishte dorëzuar. Ajo ditë nuk ishte thjesht një akt politik, ishte amaneti i brezave që u përmbush, ishte loti i nënave që u kthye në buzëqeshje krenarie, ishte gjaku i dëshmorëve që u shndërrua në simbole shtetërore. Sot, kur përmendim pavarësinë, ne përulemi me respekt thellë para atyre që sakrifikuan gjithçka për këtë ditë. Ata të cilët nuk kursyen rininë, ëndrrat, madje as jetën, që ne sot të jetojmë të lirë në tokën tonë. Liria jonë ka histori, ka plagë, por mbi të gjitha ka dinjitet. Të dashur qytetarë, Kosova jonë e vogël në hartë, por e madhe në zemër, ka kaluar nëpër sfida të shumta. Kemi dëshmuar para botës se jemi popull që di të sakrifikojë për liri dhe të punojë për paqe. Por rruga jonë nuk ka përfunduar. Gjykimi i një gjykate të padrejtë në Hagë po vazhdon ndaj krerëve të UÇK-së edhe sot. Prandaj pavarësia për ne duhet të jetë obligim. Obligim për të ndërtuar një shtet ku drejtësia nuk blihet, ku puna dhe ndershmëria vlerësohen, obligim për të qenë të bashkuar kur bëhet fjalë për interesa kombëtare, sepse shteti forcohet vetëm atëherë kur qytetarët e tij janë të bashkuar. Si përfaqësues në këtë asamblë komunale, ne kemi nderin dhe barrën e shenjtë të shërbejmë qytetarët. Çdo veprim që marrim duhet të jetë i denjë për sakrificën mbi të cilët u ndërtua ky shtet. Çdo projekt që realizojmë, duhet të jetë dëshmi se liria po shndërrohet në mirëqenie. Le ta duam Kosovën jo vetëm me fjalë, por me punë. Le ta mbrojmë atë jo vetëm me emocione por me ndershmëri. Le ta forcojmë jo vetëm me përvjetore për çdo ditë. Urime 18 vjetori i pavarësisë së Kosovës. Lavdi të përhershme dëshmorëve të Kombit. Faleminderit!

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit z. Haxhillari! E ftojme përfaqësuesin nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Haziz Hodaj (LDK): I nderuar kryetar i komunës zoti Shaqir Totaj, të nderuara familjet e dëshmorëve, përfaqësuesit e organizatave të dala nga lufta, përfaqësues të ushtrisë së Kosovës, policisë së Kosovës, të klerit fetar, të nderuar përfaqësues të bizneseve të Prizrenit, anëtarë të kuvendit, përfaqësues të medias, shoqërisë civile, të dashur qytetarë të Prizrenit. Sot shënoj me krenari ditën më të rëndësishme të historisë sonë, ditën e pavarësisë së Republikës së Kosovës, ditën e kurorëzimit të një rruge të gjatë, sakrifice, qëndrese dhe përpjekje kombëtare për liri e shtetësi. Kjo arritje historike u bë e mundur falë kontributit të gjeneratave të tëra, udhëheqës vizionare politike, luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe miqve tanë të përhershëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe aleatëve europian, të cilëve u jemi mirënjohës përjetësisht. Dita e Pavarësisë së Kosovës na rikthen kujtesën, dhimbjen, sakrificën e mbi të gjitha shpresën për realitet. Le ta festojmë me krenari, përulësi dhe përgjegjësi ndaj së ardhmes, për ata që ranë për liri, për ata që besuan pa u lëkundur dhe për brezat që vijnë. Gëzuar 17 shkurtin, rroftë Kosova e lirë, sovranë dhe demokratike. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ju faleminderit. Fjalën e ka përfaqësuesi nga Bashkimi Demokratik.

Shukri Quni (BDP): Të nderuar familjarë të dëshmorëve, invalidë dhe veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i nderuar kryetar i komunës zotëri Shaqir Totaj, i nderuar kryesues, të nderuar kolegë kuvendarë, drejtor, përfaqësues të Ushtrisë së Kosovës, pasardhës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfaqësues të policisë së Kosovës, përfaqësues të Kfor-it, përfaqësues të bashkësive fetare, media, shoqëri civile, i nderuar rektor Alishani, të nderuar të pranishëm. Sot në këtë ditë të shënuar jemi mbledhur për të festuar 17 shkurtin ditën e pavarësisë së Republikës së Kosovës, ditën që shënon kurorëzimin e një ëndrrë shekullore dhe sakrificës së popullit shqiptarë të Kosovës. Kjo ditë nuk erdhi rastësisht. Kjo ditë erdhi si rezultat i një historie që vetëm një histori të gjatë me dhunë, shtypje, diskriminim përndjekje sistematike që populli ynë e përjetoi me dekada me radhë nga pushtuesi serbo-sllav. Shqiptarëve të Kosovës ju mohuan të drejtat më elementare njerëzore. Në gjumë, në arsim, në punë, dinjitet dhe në jetë. Por përkundër kësaj dhune, burgosje, vrasjeve, spastrimit etnik, populli ynë kurrë nuk u dorëzua. Ai qëndroi i fortë, i bashkuar dhe i vendosur se liria është e pashmangshme dhe kulmi i kësaj rezistence kombëtare ishte lufta çlirimtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. UÇK-ja ishte domosdoshmëri historike! Ajo lindi nga dhimbja, nga padrejtësia dhe nga nevoja për mbijetesë. UÇK-ja ishte mburoja e popullit dhe shpresa e lirisë. Djemtë dhe vajzat më të mirë të UÇK-së lanë familjet, shtëpitë, lanë jetën e tyre, për një ideal të shenjtë. Dhe ky ideal ishte çlirimi i Kosovës. Ata luftuan me armë në dorë, por mbi të gjitha me besim të palëkundur se e drejta ishte në anën tonë. Gjaku i dëshmorëve tanë, është themel mbi të cilën u ndërtua liria dhe shteti ynë. Falë kësaj lufte heroike dhe dëshmorëve, falë edhe qëndresës së popullit dhe aleatëve tanë ndërkombëtarë, në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kosova u çlirua në qershor të vitit 1999. Dhe sot me 17 shkurt 2008, kjo liri u vulos përfundimisht me shpalljen e pavarësisë së Republikës së Kosovës. Ky ishte një moment historik jo vetëm për Kosovën, por për gjithë kombin shqiptar dhe për vlerat e lirisë dhe të demokracisë. Ndërsa sot, në këtë ditë feste, nuk mund t'i mbylлим sytë para një padrejtësie të madhe e cila po ju bëhet krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ata që e themeluan shtetin e Kosovës. Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe shokët e tjerë çlirimtarë që vazhdojnë të mbahen ende peng në Hagë. Ata udhëhoqën luftën çlirimtare, ata ishin në ballë të mbrojtjes së popullit dhe sot përballen me procese që e rëndojnë jo vetëm mbi individë, por edhe mbi vetë historinë e luftës sonë. Ne besojmë fuqishëm se lufta e UÇK-së ishte e drejtë, e pastër dhe çlirimtare. Asnjë gjykatë nuk mund ta tjetërsojë të vërtetën historike. Asnjë proces nuk mund ta njollojë sakrificën e popullit që ka luftuar për mbrojtje dhe liri. Kosova ka obligim moral, politik dhe historik t'ju qëndrojë pranë luftëtarëve të saj, pranë vlerave të luftës dhe pranë të vërtetës. Sot, në përvjetorin e 18 të Pavarësisë së Kosovës, ne përulemi para dëshmorëve, para martirëve, para atyre që dhanë më të shtrenjtën lirinë, duke filluar prej komandantit legjendar Adem Jasharit dhe familjes së tij, familjes Haradinaj, heroit të kombit Remzi Ademaj, komandant Petriti, heroit Xhevat Berisha, Selajdin Berisha, Agim Shala dhe të gjithë dëshmorët që dhanë jetën për lirinë e sotme që ne e gëzojmë. Si institucione komunale dhe si shoqëri kemi përgjegjësi të madhe ta ruajmë shtetin, ta forcojmë ligjin, ta mbrojmë lirinë dhe ta ndërtojmë Kosovën ashtu siç e kishin ëndërruar dëshmorët. Pra një Kosovë të drejtë, të zhvilluar me perspektivë për brezat që do të vijnë.

Le të jetë kjo ditë zotim, se Kosova do të ecë përpara, e bashkuar, krenare dhe e pa lëkundur në rrugën e saj shtetërore. Lavdi dëshmorëve të kombit. Lavdi Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në emër të Bashkimit Demokratik për Prizren dhe kryetarit Zafir Berisha, gëzuar të gjithëve 17 shkurtin, ditën e pavarësisë së Kosovës. Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Vazhdojmë me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës.

Agim Muqaj (AAK): I nderuar kryetar Totaj, ekzekutiv i nderuar, kryesues i nderuar. Unë përshëndetjen dëshiroj ta filloj me përfaqësuesit dhe trashëgimtarët drejtpërdrejtë të Ushtrisë Kombëtare të Kosovës, forcat të sigurisë së Kosovës dhe shërbimin policor të Kosovës. Të nderuar klerik, i nderuar zotëri Alishani, i nderuar deputet Gashi, faleminderit për pjesëmarrjen, të nderuar përfaqësues të shoqatës të dala nga lufta, i nderuar komandant Xhemshit Krasniqi, ikona e ushtrisë shtetërore të Kosovës në rrethin e Prizrenit. Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj. Të nderuar kolegë kuvendar, të nderuar qytetarë të Prizrenit, të Kosovës dhe të gjithë shqiptarëve ku jeni. Jam krenar që gëzoj plagët e lirisë, që mora pjesë drejtpërdrejt në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Por sigurisht se jam i lënduar, asgjë nuk më dhëmbin plagët e mia dhe gjithë plagët e gjithë shokëve, të lënduar të gjithë jemi me një padrejtësi që po i ndodh popullit tonë të Kosovës. Jo veç ne si shoqëri, unë mendoj se edhe kjo tokë nuk mund të jetë e qetë pa u kthyer sa më shpejt presidenti Hashim Thaçi, njeri themeltar i Ushtri Çlirimtare të Kosovës. Pa u kthyer Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe të gjithë ata që gjykuan padrejtësisht atje. Ju lutem, sigurisht se nuk mund ta ndjej veten mirë. I shihni rrethanat në çfarë rrethanave po përjetojnë. Ndaj procesit të milosheviçit, ishin vetëm 60 shqiptarë që dëshmuar në atë proces. Çfarë ironie? Kurse në procesin e bashkëlufëtareve tonë, ata që dhanë më së shumti për këtë vend, morën pjesë mbi 200 shqiptarë, të cilët bashkëpunuan, u manipuluan, u paguan me një proces i cili që nga fillimi ishte i manipuluar. Kjo është një padrejtësi që i ka ndodhur këtij vendi. I lutem Zotit që të gjithë kjo shoqëri që të vetëdijësohet dhe t'i presim ata njerëz sepse sigurisht se nuk mund të jetë e qetë as toka dhe as ne. Unë në këtë ditë të sotme, sigurisht se gjithmonë që nga pas lufta kam qenë edhe kritik, pavarësisht se kush ka udhëhequr në Prizren dhe kudo. Unë kisha dashur që edhe kryetari Totaj, edhe ekzekutivi, që për kategoritë e luftës mos ju bije mend, vetëm kur ka 12 qershore, vetëm kur ka 17 shkurta apo 28, por ndaj kësaj shoqërie duhet të jemi për çdo ditë dhe të japim privilegjin e merituar djemtë dhe vajzave dhe familjeve të tyre si në punësim, rehabilitim dhe kudo. Po nga kjo foltore i drejtohem kryeministrit të Kosovës që qysh në dy-tri seancat e para ta ri sjellë ligjin në mënyrë urgjente që të rregullohet që të mbrohem me dinjitet dhe me ligj dhe jo me subvencione vetëm ata kur dëshirojnë. Urime të gjithë shqiptarëve kudo që janë, kjo ditë dhe dhashë Zotit që pavarësia e vitit të ardhshëm të na gjejë së bashku me të gjithë ata që na mungojnë në vendin tonë. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ju faleminderit. Vazhdojmë me përfaqësuesen nga Nisma Social-Demokrate.

Albulena Balaj-Halimaj (Nisma): Faleminderit kryesues, i nderuar kryesues, i nderuar kryetar Totaj, i nderuar deputet Gashi. Të nderuar përfaqësues të policisë, të nderuar përfaqësues të FSK-së, të institucioneve të besimeve fetare, i nderuar rektor dhe të nderuar të gjithë ju të pranishëm.

Sot më lejoni që nëpërmjet vëllaut tim që qenka i ftuar si veteran i UÇK-së, të përshëndes dhe të uroj secilin veteran dhe secilën familje që dha kontributin e pa çmim për këtë ditë të sotme. Sot shënojmë 18-vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ditën kur me 17 shkurt 2008 në Kuvendin e Republikës u vulos vullneti i popullit tonë për liri dhe pavarësi. Kjo ditë është kurorëzim i sakrificës së brezave të tërë, është amaneti i atyre që nuk u përkulën, i atyre që besuan se Kosova një ditë do të duhej të bëhej e lirë dhe sovranë. Është dita kur ëndrra u bëra realitet, kur shteti ynë u ngrit mbi themelet e gjakut dhe sakrificës. Ne përulemi me nderim para dëshmorëve të kombit, para familjeve që sakrifkuan më të shtrenjtët për lirinë tonë, para veteranëve e invalidëve të UÇK-së. Ata janë meritoret e lirisë. Ata janë arsyeja pse sot flasim lirshëm, jetojmë lirshëm në shtetin tonë dhe ndërtojmë lirshëm të ardhmen tonë. Por liria nuk është vetëm çlirim nga pushtimi, liria është edhe përgjegjësi. Shteti ynë nuk mund të ndërtohet vetëm me fjalë e me simbole, ai ndërtohet me institucione të forta me ligj që vlen për të gjithë, me barazi para ligjit. Ndërtimi i shtetit të së drejtës duhet të jetë angazhimi ynë i përditshëm. Pa drejtësi, liria mbetet e cunguar, pa barazi para ligjit, shteti mbetet i brishtë. Sot në këtë përvjetor ne festojmë, por edhe reflektojmë, a po e ndërtojmë Kosovën ashtu siç e ëndërruan ata që ranë për të? Le të mos harrojmë, shteti që duam është ai ku askush nuk është mbi ligjin, por ku ligji është i barabartë për të gjithë. Është shteti që respekton luftën e drejtë, që ndërton paqe të qëndrueshme mbi drejtësi të vërtetë. Kët 17 shkurt, krahas festës së pavarësisë, do të organizohet edhe një protestë në mbrojtje të luftës tonë të drejtë, e cila po gjykohet në Hagë. Kjo protestë nuk është kundër askujt. Ajo është një thirrje për drejtësi, për dinjitet dhe mbi të gjitha për drejtësi në gjykim. Sot atje, në atë që shumë kush e quan beteja e fundit e UÇK-së, po përballen katër drejtues të luftës sonë për liri dhe shtet të pavarur: Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi. Në deklaratimet e tyre, në fillim të procesit, ata jo vetëm që u deklaruan plotësisht të pafajshëm, por me kokën lart theksuan se UÇK-ja nuk ka qenë ndërmarrje e përbashkët kriminale, siç pretendon prokuroria, por ndërmarrje e përbashkët çlirimtare e një populli të robëruar, me në krye komandantin legjendar Adhem Jashari. Sot, kur jemi në fund të procesit, pas më shumë se pesë vite, është bërë më se e qartë se fjala që ata e thanë në fillim ka marrë peshë tjetër. Tani më kanë peshën e të vërtetës absolute, se UÇK ishte dhe mbetet një ndërmarrje çlirimtare e një populli të robëruar. Gjatë gjithë kësaj kohe, ata kanë qëndruar me dinjitet duke mbrojtur jo vetëm veten, por edhe karakterin çlirimtar të luftës sonë. Ne besojmë se drejtësia është themeli i shtetit që kemi ndërtuar, por drejtësia nuk duhet të jetë selektive. Prandaj është e domosdoshme që drejtësia ndërkombëtare ta trajtojë historinë tonë me paanshmëri dhe sa më shpejt t'i lirojë heronjtë e luftës dhe të paqes, në mënyrë që ata të kthehen në vendin e tyre për të cilin luftuan dhe pranë familjeve të tyre. Sot në 18 vjetorin e shtetit tonë, ne duhet të jemi të bashkuar në festë dhe në kërkesën për drejtësi, sepse një Kosovë e bashkuar është një Kosovë shumë më e fortë. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ju faleminderit, vazhdojmë me listën Guxo.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit i nderuar kryesues, i nderuar kryetar, të nderuar mysafirë, nga të gjitha institucionet shtetërore, zonja dhe zotërinj, nëpërmjet kësaj foltore në emrin tim personal dhe në emrin e Partisë Guxo, ju urojmë 17 shkurtin, ditën e pavarësisë së Republikës së

Kosovës. Kjo ditë është ndër ditët më të rëndësishme në historinë tonë kombëtare, ditë që kurorëzon sakrificën shekullore të popullit tonë për liri, dinjitet dhe shtetësi. Është dita kur ëndrra e shumë brezave u bë realitet dhe Kosova u rreshtua në mesin e shteteve të lira dhe sovrane. 17 shkurti na kujton përgjegjësinë që kemi ne sot si përfaqësues të qytetarëve të Kosovës, të punojmë me ndershmëri, transparencë dhe përkushtim për një shtet ligjor, për barazi, drejtësi sociale dhe zhvillim të qëndrueshme për të gjithë qytetarët pa dallim. Në këtë ditë të shënuar nderojmë dëshmorët dhe martirët e kombit, familjet e tyre dhe të gjithë ata që kontribuan në rrugët e vështira drejt lirisë dhe pavarësisë. Sakrifika e tyre na obligon që Kosova të ndërtohet çdo ditë e më fortë, më demokratike dhe më e drejtë. Le të jetë 17 shkurti jo vetëm festë, por edhe ditë reflektimi dhe angazhimi për një të ardhme më të mirë për vendin tonë dhe për brezat që vijnë. Urime 17 shkurtin, ditën e pavarësisë së Republikës së Kosovës. Lavdi të gjithë atyre që dhanë lirinë për këtë vend. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ju faleminderit. Vazhdojmë me përfaqësuesin nga KDTP-ja.

Sevilya Hapçi (Kdtp): Sayın Belediye Başkanı, Belediye Başkan yardımcıları, meclis Başkanı, Müdürlerimiz, meclis üyelerimiz, Kosova Askeri mensupları, T. C. Başkonsolosumuz, İslam Birliği, Kosova Polisi, Prizren Üniversitesi Rektörü, Şehit aileleri, basın mensupları ve bizleri izleyen değerli Prizrenli halkı hepinizi saygıyla selamlıyorum. KDTP temsilcisi olarak Kosova Cumhuriyetinin bağımsızlığının 18. yılını kutlarım. 17 Şubat, Kosova halkının özgürlük uğruna verdiği mücadelenin ve ödediği ağır bedellerin sembolüdür. Kosova'nın bağımsızlığı bir günde kazanılmadı. Zor yıllardan geçti. Savaşın acılarını yaşadı, göçleri gördü, kayıplar verdi. Ama umudunu hiç yitirmedi ve sonunda özgür bir devlet olmayı hak etti. İşte bu yüzden bağımsızlık bizim için sadece siyasi bir karar değil, bir halkın yeniden ayağa kalkmasının hikâyesidir. Bu özgürlük; başta Adem Jashari olmak üzere, Kosova Kurtuluş Ordusu'nun (UÇK) verdiği mücadele ve şehitlerimizin fedakârlığı sayesinde mümkün oldu. Özgürlük uğruna canlarını feda eden tüm kahramanlarımızı saygı, minnet ve rahmetle anıyorum. Onların fedakârlığı, bu devletin temelinde sonsuza kadar yaşayacaktır. Kosova, farklı dillerin, kültürlerin ve toplulukların ortak evidir. Bağımsızlığımızın en büyük gücü de bu birliktir. Birlik içinde yaşama irademiz, geçmişte olduğu gibi bugün de Kosova'nın en sağlam teminatıdır. Bağımsızlık sadece geçmişin bir zaferi değildir; bağımsızlık, her gün emekle, adaletle ve dayanışmayla korunması gereken bir değerdir. Gelecek nesillere daha güçlü bir Kosova bırakmak hepimizin ortak sorumluluğudur. Bağımsızlığımız Kutlu olsun! Urime Ditën e Pavarësisë, Kosovë!

Simir Krasniqi (Kryesues): Vazhdojmë me përfaqësuesin nga Ythp.

Sevil Kazaz (Ythp): Sayın belediye başkanımız, Belediye Başkan yardımcılarımız, Prizren belediyesi yönetimi ve meclis temsilcileri, UÇK savaş gazileri aileleri, dernek temsilcileri, Kosova askeri birliği ve polis teşkilatı temsilcileri, TC. sn. Baş konsolosu, Prizren Üniversitesi Rektörü, Prizren İslam birliği başkanı, değerli katılımcılar hepiniz, saygıyla selamlıyorum. Kosova Cumhuriyetinin bağımsızlık kutlaması oturumuna hoş geldiniz. Bağımsızlığımızın 18. Yılında bizlere bu günleri emanet eden şehitlerimizi başta Adem Jashari, ailesini, Prizren'in eşsiz komutanı

Ekrem Rexha Komutan Drini ve Kosova Türkü şehidimiz Ersan Mazreku ve tüm şehitlerimizi rahmetle anıyorum. Ruhları şad olsun. Bu vatani bize emanet ettiler, bizim de üzerimize düşen görev elimizden gelen çabayı göstererek daha güçlü daha istikrarlı ve daha güvenli bir Kosova için çalışmak olmalıdır! Savaş yıllardır ülkemizi, vatandaşlarımızı çok yordu, hala kayıp olan yüzlerce Kosovalı var, onları bekleyen yüzlerce aile! Bugün hala haksızca Yargılanan Kosova'nın hükümet temsilcileri...Bu zorlu süreçlerden geçerken bu günlere nasıl geldiğimizi hiçbir zaman unutmamalıyız! Birlikte barış içinde yaşamının değerini bilmeliyiz. Bağımsızlık sadece ülkedeki Arnavut topluluğu için değil, savaşta evlerinde barışı korkuyla bekleyen, ülkesine sahip çıkan, bağımsızlık sürecinde hükümetin tüm kurumlarına destek sunan Türk, Boşnak, Rom, Aşkali, Mısırlı, Goralı ve Kosova'da yaşayan tüm toplulukları için de çok önemlidir. Çok etnikli bir ülkede yaşamakta olduğumuzun bilinciyle tüm toplumlara karşı saygılı, hoşgörülü, toleranslı davranarak, çocuklarımıza daha güzel bir ülke bırakmak bizlerin elinde. YTHP temsilcisi olarak Ülkimize, Kosova vatandaşlarımıza ve bizlerle sevincimizi paylaşan dostlarımıza Bağımsızlık yıl dönümümüz bir kez daha kutlu olsun. Saygılarımla teşekkür ederim. Urime Pavarësinë e Kosovës! Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Vazhdojmë me përfaqësuesin nga Vakati.

Eldis Abazi (Vakati):

Simir Krasniqi (Kryesues): Vazhdojmë me përfaqësuesin nga Sdu.

Dzengis Saliji (Sdu):

Simir Krasniqi (Kryesues): E ftojme kryetarin Shaqir Totaj për një fjalë rasti!

Shaqir Totaj (Kryetar i Komunës): I nderuar kryesues i Kuvendit Komunal, të nderuar asambleistë dashur përfaqësues të institucioneve, veteranë, familjet e dëshmorëve, qytetarë të nderuar, zonja dhe zotërinj, përfaqësues të Policisë së Kosovës, përfaqësues të FSK-së, përfaqësues të organizatave të dala nga lufta, i nderuari rektor, dëshiroj të përshëndes po ashtu edhe konsullin e Republikës Turke, përfaqësuesit e bizneseve, si dhe mediat. Është nder i veçantë që sot në këtë seancë solemne të jemi bashkë për të shënuar 18-vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës. Gjithsesi një moment historik që përmbledh në vetvete sakrificën, qëndresën dhe aspiratat shekullore të të gjithë popujve që jetojnë në Kosovë për liri dhe shtetësi. Jemi mbledhur këtu jo vetëm për të festuar, por për të reflektuar mbi rrugën që kemi bërë dhe mbi përgjegjësinë që mbajmë për të forcuar shtetin tonë çdo ditë. Rruga drejt lirisë u ndërtua mbi sakrificë të mëdha dhe mbi vendosmërinë e një populli që nuk hoqi dorë kurrë nga e drejta për të jetuar i lirë. Lufta e drejtë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës mbetet themeli i kësaj lirie dhe një kapitull i lavdishëm i historisë tonë. Në këtë rrugëtim historik, me rëndësi të thellë kujtojmë presidentin historik Ibrahim Rugovën, i cili me vizionin dhe udhëheqjen e tij të mençur në rrethinë ndërkombëtare, kontribuoi në fuqizimin e kauzës së Kosovës dhe në ndërtimin e themeleve të shtetit tonë. Po ashtu nderojmë Hashim Thaçin si udhëheqës të luftës për çlirim dhe si shpallës të pavarësisë së Kosovës në Kuvendin e Republikës së Kosovës për rolin e tij në momentet

vendimtare të historisë tonë. Sot, ndërsa shënojmë këtë përvjetor, mbetemi të përkushtuar ndaj vlerave të drejtësisë dhe të së vërtetës. Proceset gjyqësore po zhvillohen ndaj ish-drejtuesve të UÇK-së, perceptohen nga shumë qytetarë si të padrejta dhe në këtë ditë në Prishtinë, sot në ora 14:00 mbahet marshi kundër padrejtësisë si shprehje e solidaritetit dhe kërkesës për drejtësi. Të nderuar të pranishëm, pavarësia është përgjegjësi e përditshme, është angazhim për të ndërtuar institucione të forta, për të forcuar demokracinë, për të zhvilluar ekonominë dhe për të garantuar mirëqenie për çdo qytetar. Prizreni si qytet i historisë dhe i bashkëjetesës mbetet shembull i vlerave që na bashkojnë. Detyra jonë është që me përkushtim dhe përgjegjësi ta çojmë përpara këtë trashëgimi dhe të punojmë për një të ardhme më të sigurtë dhe më të zhvilluar dhe më të mirë për të gjithë. Le të jetë ky përvjetor një moment për të ripërtëri zotimet tona ndaj Kosovës për unitet, për përparim dhe për respekt ndaj sakrificës mbi të cilën është ndërtuar shteti ynë. Lavdi të gjithë atyre që sakrifikuan për lirinë tonë. Urime 18-vjetori i Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Ju faleminderit për vëmendjen edhe për pjesëmarrjen.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ju faleminderit i nderuar kryetar, duke ju falënderuar për pjesëmarrje. Ju ftoj të gjithëve së bashku të shkojmë për homazhin në varrezat e dëshmorëve dhe nga aty në mashin për drejtësinë në Prishtinë, në sheshin Skënderbeu në ora 2:00. Të gjithë së bashku. Urime dita e pavarësisë!

**Kryesuesi i Kuvendit
Simir Krasniqi**



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kuvendi i Komunës

Nr. 001/060-32283

Më: 18 mars 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 43 të Ligjit Nr. 04/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 30 paragrafit 1 dhe nenit 35 paragrafit 2, të Statutit të Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-5643, dt. 15 tetor 2008, thërras mbledhjen e III/2026 (e tretë) të rregullt të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, e cila do të mbahet më: **30 mars 2026 (e hënë)**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në **ora 10:00**.

Prandaj, ftoheni që në cilësinë e anëtarit të Kuvendit të Komunës, të merrni pjesë në punën e kësaj mbledhjeje, duke ju përmbajtur orës, datës dhe vendit të caktuar.

Për punën e kësaj mbledhjeje, propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme të datës 23 janar 2026 dhe mbledhjes solemne të datës 17 shkurt 2026;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin dhe përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi të Komunës së Prizrenit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për Shoqatën “Zona e Pashtrikut”;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e komisionit dhe emërimin e anëtarëve të komisionit për emërimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Prizrenit.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit nr.001/011-60689, të datës 02 korrik 2020 për mënyrën e pagesës së taksës administrative për leje ndërtimore, leje rrërimi dhe tarifa për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.001/011-68302, të datës 29.05.2025;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përgjdhjen e këshillave lokale;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për emërimin e komisionit të ankesave për procesin e zgjedhjes së këshillat lokale.



Kryesuesi i Kuvendit
Simir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Belediye Meclisi
No. 001/060-32283
Tarih: 18 Mart 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Yerel Özyönetim Kanun'un 43.maddesi, 15 Ekim 2008 tarihli ve 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğü'nün 30. Maddesi, 1. Fıkrası, 35. Maddesi, 2. Fıkrası gereğince **30 Mart 2026 tarihinde (Pazartesi günü)** saat 10.00'dan başlayarak **"Beyaz Evde"** Prizren Belediye Meclisi oturum salonunda düzenlenecek olan Prizren Belediye Meclisin III./2026 (üçüncü) düzenli oturumu çağırıyorum. Belediye Meclisi üyesi niteliğinde işbu oturum çalışmaları için belirtilen saat, tarih ve yerde katılmanız üzere davetlisiniz:

İşbu toplantı için şu gündem noktaları belirlenmiştir.

GÜNDEM

1. 23 Ocak 2026 tarihli olağanüstü ve 17 Şubat 2026 tarihli resmi törenli toplantı tutanaklarının görüşülmesi ve onaylanması;
2. Gündemin görüşülmesi ve onaylanması;
3. Meclis üyelerin soruları ve çeşitli konuların dile getirilmesi;
4. Prizren Belediyesi Toplum Güvenlik Konseyi'nin kurulması ve bileşimine ilişkin teklif-kararın incelenmesi ve onaylanması;
5. "Zona e Pashtrikut" Derneğine mali kaynakların tahsisine ilişkin öneri kararın görüşülmesi ve onaylanması;
6. Prizren Belediyesi sınırları içindeki yolların, meydanların ve semtlerin adlandırılması için Komisyonun kurulmasına ve üyelerinin atanmasına ilişkin öneri kararın görüşülmesi ve onaylanması.
7. Prizren şehri sınırları içinde yapı ruhsatı, yıkım izni ve altyapı düzenleme ücretlerine ilişkin idari harcın ödenme yöntemine dair 02 Temmuz 2020 tarihli 001/011-60689 sayılı kararın iptaline ilişkin öneri kararın görüşülmesi ve onaylanması;
8. 29.05.2025 tarihli 001/011-68302 sayılı kararın değiştirilmesine ve tamamlanmasına ilişkin öneri kararın görüşülmesi ve onaylanması;
9. Yerel kurulların seçiminde saha çalışmalarının yürütülmesi ve koordinasyonu için Komisyonun atanmasına ilişkin öneri kararın görüşülmesi ve onaylanması;
10. Yerel kurulun seçim sürecine ilişkin şikâyetleri inceleyecek Komisyonun atanmasına dair öneri kararın görüşülmesi ve onaylanması;



Meclis Başkanı
Simir Krasniqi



Në bazë të nenit 12 paragrafi 1,2 pika. d), lidhur me nenin 58 paragrafi 1 pika h) të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 50 paragrafi 1 pika l), lidhur me nenin 27 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, neni 3 pika 2 dhe neni 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL, si dhe në bazë të Ftesës Publike me nr. 0 1-060/01-0006664/2026, datë 15.01.2026, për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, Kryetari i Komunës së Prizrenit propozon këtë:

Propozim –Vendim

për themelimin dhe përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi të Komunës së Prizrenit

Neni 1

Kuvendi i Komunës të merr vendim për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi të Komunës së Prizrenit.

Neni 2

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi përbëhet nga këta anëtarë:

1. Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës –kryesues;
2. Sead Arifi, Drejtor për Emergjencë dhe Siguri- anëtar;
3. Nexhdet Marsori, Komandant i Stacionit Policor ‘‘Alfa Prizren’’- anëtar;
4. Haxhi Kabashi, Komandant i Stacionit Policor ‘‘Veri’’, Prizren- anëtar;
5. Arben Elshani, Komandant i Stacionit Policor të Trafiku, Prizren –anëtar;
6. Azem Krasniqi, Komandant i Stacionit Policor -Pika Vërmicë- anëtar;
7. Latif Hoxha, Komandant i Stacionit Policor ‘‘Vija e Gjellbër’’- anëtar;
8. Vedat Shatri. përfaqësues (Toger) i Forcave të Armatosura të Kosovës- anëtar;
9. Mr.ef. Valon Ibrahim, përfaqësues i Bashkësisë Islame- anëtar;
10. Marin Pergjokaj, përfaqësues i Kishës Katolike- anëtar;
11. Dushan Kovaqeviq, përfaqësues i Kishës Ortodokse- anëtar;

12. Gani Demiri, përfaqësues i Hebrenjve të Kosovës- anëtar;
13. Furkan Shehu, përfaqësues i Tarikateve të Kosovës- anëtar;
14. Besim Kryeziu, përfaqësues i Kishës Protestante Ungjillore të Kosovës- anëtar;
15. Adra Maloku, përfaqësuese e komunitetit turk- anëtare;
16. Asim Imeri, përfaqësues i komunitetit boshnjak- anëtar;
17. Spasa Andijević, përfaqësues i komunitetit serb- anëtar;
18. Islam Elshani, përfaqësues i komunitetit RAE- anëtar;
19. Adilj Gurguska, përfaqësues i komunitetit goran – anëtar;
20. Sevilay Igci-Hapçi, Kryesuese e Komitetit për Komunitete- anëtare;
21. Mybexhele Zhuri, Zyrtare për Barazi Gjinore – anëtare;
22. Luljeta Veselaj Gutaj, Drejtoreshë në Drejtorinë për Arsim dhe Shkencë- anëtare;
23. Zihnie Gurmani, Kryetare i Këshillit të Prindërve të Arsimit në Komunën e Prizrenit- anëtare;
25. Sedat Bajrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike –Mushnikovë- anëtar;
26. Nehat Vehapi, përfaqësues i Këshilli Lokal për Siguri Publike- Lubizhdë- anëtar;
27. Idaim Kryeziu, përfaqësues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi- anëtar;
28. Simon Veseli, përfaqësues i Këshilli Lokal për Siguri Publike- Velezhë- anëtar;
29. Derya Kala, Udhëheqëse e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim –anëtare;
30. Eroll Shabani, përfaqësues i OJQ-së ‘EC Ma Ndryshe’- anëtar;
31. Varis Xhejlani, përfaqësues i shoqatës ESNAF nga komuniteti i bizneseve- anëtar;
32. Fisnik Minci, përfaqësues i mediave lokale- anëtar;
33. Merita Shala, përfaqësuese e personave me nevojë të veçanta - anëtare.

Neni 3

Punët, kompetencat dhe detyrat e Këshillit dhe anëtareve të tij përcaktohen me Udhëzim Administrativ nr. 27/2012 MPB-së dhe nr. 03/2012 të MAPL-së.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi, 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesues i KKSB-së

Shaqir Tetaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Na osnovu člana 12 stav 1, 2. tačka d), u vezi sa članom 58 stav 1 tačka h) Zakona br. 03/L-040 o Lokalnoj Samoupravi, člana 50 stav 1 tačka l), u vezi sa članom 27 stav 1 Statuta opštine Prizren, člana 3 tačka 2 i člana 4 Administrativnog uputstva br. 27/2012 MUP – 03/2012 MALS, kao i na osnovu Javnog poziva br. 0 1-060/01-0006664/2026, od dana 15.01.2026. godine, za Opštinski Savjet za Sigurnost Zajednice, Gradonačelnik Prizrena predlaže ovo

Predlog Odluku

o osnivanju i sastavu Opštinskog saveta za bezbednost zajednice opštine Prizren

Član 1

Skupština opštine da donese odluku o izboru novih članova Opštinskog Saveta za Sigurnost Zajednice opštine Prizren.

Član 2

Opštinski Savet za Sigurnost Zajednice sastoji se od sljedećih članova:

1. Shaqir Totaj – Gradonačelnik opštine/predsedavajući;
2. Sead Arifi, Direktor za Emergentnost i Sigurnost-član;
3. Nexhdet Marsori, Komandir Policijske Stanice “Alfa Prizren”- član;
4. Haxhi Kabashi, Komandir Policijske Stanice “Sever-Prizren” - član;
5. Arben Elshani, Komandir stanice saobraćajne policije - Prizren – član;
6. Azem Krasniqi, Komandir Policijske Stanice “Tačka Vrbnica” - član;
7. Latif Hoxha, Komandir Policijske Stanice „Zelena Linija,, - član;
8. Vedat Shatri, predstavnik (poručnik) Oružanih Snaga Kosova-član;
9. Mr.ef. Valon Ibrahim, predstavnik Islamske Zajednice - član;
10. Marin Pergjokaj, predstavnik katoličke Crkve -član;
11. Dušan Kovačević, predstavnik Pravoslavne Crkve - član;

12. Gani Demiri, predstavnik jevreja Kosova - član;
13. Furkan Shehu, predstavnik Tarikata Kosova - član;
14. Besim Kryeziu, predstavnik Evangeličke protestantske crkve Kosova - član;
15. Adra Maloku, predstavnik turske zajednice - član;
16. Asim Imeri, predstavnik bošnjačke zajednice - član;
17. Spasa Andrijević, predstavnik srpske zajednice - član;
18. Islam Elshani, predstavnik RAE zajednice - član;
19. Adilj Gurguska, predstavnik goranske zajednice - član;
20. Sevilay Igci-Hapçi Predsedavajući Komiteta za Zajednice - član;
21. Mybexhele Zhuri, Službenica za Rodnu Ravnopravnost - član;
22. Luljeta Veselaj Gutaj, Direktorica u Direktorijatu za Obrazovanje i Nauku - član;
23. Zihnie Gurmani, Predsjedavajući Vijeća roditelja za obrazovanje u opštini Prizren, član,
25. Sedat Bajrami, predstavnik Lokalnog Saveta za Javnu Sigurnost –Mušnikovo - član;
26. Nehat Vehapi, predstavnik Lokalnog Saveta za Javnu Sigurnost – Ljubižda - član;
27. Idaim Kryeziu, predstavnik Akcionog Tima za Sigurnost u Zajednici - član;
28. Simon Veseli, predstavnik Lokalnog Saveta za Javnu Sigurnost –Veleža - član;
29. Derya Kala, Rukovodilac opštinske Kancelarije za Zajednice i Povratak – član,
30. Eroll Shabani , predstavnik NVO “EC Ma Ndryshe”- član;
31. Varis Xhejlani, predstavnik udruženja ESNAF iz poslovne zajednice - član,
32. Fisnik Minci , predstavnik lokalnih medija - član;
33. Merita Shala, predstavnik osoba sa posebnim potrebama - član.

Član 3

Zadaci, nadležnosti i dužnosti Saveta i njegovih članova određeni su Administrativnim uputstvom br. 27/2012 MUP-a i br. 03/2012 MALS.

Član 4

Ova odluka stupa na snagu 30 dana nakon što je dostavljena nadzornom organu, u skladu sa članom 8, u vezi sa članom 9 Zakona br. 08/L-284 o Administrativnom Razmatranju Opštinskih Akata i nakon objavljivanja na službenim jezicima na službenoj web stranici opštine.

Predsedavajući OSSZ
Shaqir Totaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

03/L-040 sayılı Yerel Öz Yönetim Kanun'un 12. Maddesi, 1,2. Fıkrası, d) noktası ile bağlantılı olan 58. Maddesi, 1. Fıkrası, h) noktası, Prizren Belediye Tüzüğü'nün 27. Maddesi, 1. Fıkrası ile bağlantılı olan 50. Maddesi, 1. Fıkrası, l) noktası, 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL sayılı İdari Talimat 3. Maddesi, 2. Noktası, 4. Maddesi ve ayrıca 15.01.2026 tarihli ve 0 1-060/01-0006664/2026 sayılı Toplulukta Belediye Güvenlik Konseyin kamu davetine istinaden Prizren Belediye Meclisi aşağıda yer alanları önermiştir:

Prizren Belediye Güvenlik Konseyi ile ilgili Belediye Kurulun kurulması ve oluşumu ile ilgili öneri – karar

Madde 1

Belediye Meclisi, Prizren Belediyesinde Toplulukta Güvenlik Konseyin yeni üyelerinin seçilmesi için karar alması önerilmiştir.

Madde 2

Toplulukta Belediye Güvenlik Konseyi aşağıda yer alan üyelerden oluşmaktadır:

- 1..Shaqir Totaj, Belediye Başkanı –Başkan;
2. Sead Arifi, Acil ve Güvenlik Müdürü- üye;
3. Nexhdet Marsori, ‘‘Alfa Prizren’’ Polis Karakolu Komutanı - üye;
4. Haxhi Kabashi, ‘‘Veri’’-Prizren Polis Karakolu Komutanı - üye;
5. Arben Elshani, Prizren - Trafik Polis Karakolu Komutanı –üye;
6. Azem Krasniqi, Vërmicë Noktası Polis Karakolu Komutanı - üye;
7. Latif Hoxha, ‘‘Vija e Gjelbër’’ Polis Karakolu Komutanı - üye;
8. Vedat Shatri. Kosova Silahlı Kuvvetleri temsilcisi (Teğmen) -üye;
9. Mr.ef. Valon Ibrahim, İslam Birliği temsilcisi- üye;
10. Marin Pergjokaj, Katolik Kilisesi temsilcisi- üye;
11. Dushan Kovaqeviq, Ortodoks Kilisesi temsilcisi - üye;

12. Gani Demiri, Kosova Yahudilerinin temsilcisi – üye;
13. Furkan Shehu, Kosova'daki tarikatların temsilcisi – üye;
14. Besim Kryeziu, Kosova Protestan Evanjelik Kilisesi temsilcisi – üye;
15. Adra Maloku, Türk topluluğu temsilcisi – üye;
16. Asim Imeri, Boşnak topluluğu temsilcisi – üye;
17. Spasa Andijević, Sırp topluluğu temsilcisi – üye;
18. Islam Elshani, RAM topluluğu temsilcisi – üye;
19. Adilj Gurguska, Goran topluluğu temsilcisi – üye;
20. Sevilay Igci-Hapçi, Topluluklar Komitesi Başkanı – üye;
21. Mybexhele Zhuri, Toplumsal Cinsiyet Eşitliği Görevlisi – üye;
22. Luljeta Veselaj Gutaj, Eğitim ve Bilim Müdürlüğü Müdürü – üye;
23. Zihnie Gurmani, Prizren Belediyesi Eğitim Ebeveynler Konseyi Başkanı – üye,
25. Sedat Bajrami, Mushnikovë Yerel Kamu Güvenliği Konseyi Temsilcisi – üye;
26. Nehat Vehapi, Lubizhdë Yerel Kamu Güvenliği Konseyi Temsilcisi – üye;
27. Idaim Kryeziu, Toplulukta Güvenlik Yürütme Ekibi Temsilcisi – üye;
28. Simon Veseli, Velezh Yerel Kamu Güvenliği Konseyi Temsilcisi – üye;
29. Derya Kala, Belediye Topluluklar ve Geri Dönüş Ofisi Müdürü – üye,
30. Eroll Shabani, EC Ma Ndryshe' STK Temsilcisi – üye;
31. Varis Xhejlani İş Dünyası Topluluğundan ESNAF Derneği Temsilcisi – üye,
32. Fisnik Minci, Yerel Medya Temsilcisi – üye;
33. Merita Shala, Özel Gereksinimli Kişiler Topluluğu Temsilcisi – üye.

Madde 3

Kurul ve üyelerinin çalışmaları, yetki ve görevleri 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL sayılı İdari Talimat ile belirlenmektedir.

Madde 4

Bu karar, denetim organına gönderildikten 30 gün sonra yürürlüğe girer; bu süre, 08/L-284 sayılı Belediye Kararlarının İdari İncelemesi Hakkında Kanunun 8. ve 9. maddeleri uyarınca uygulanacaktır ve karar, belediyenin resmi web sitesinde resmi dillerde yayımlandıktan sonra geçerlilik kazanır.

TBGK Başkanı
Shaqir Totaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kuvendi i Komunës

Nr. 001/011 –

Më: __ mars 2026

Në bazë të nenit 12, paragrafit 1 dhe 2 shkronja d), nenit 40 paragrafi 2 shkronja c), nenit 17 shkronja g, nenit 58 shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 27 paragrafit 1, nenit 25 paragrafit 1 shkronja c) nenit 50 shkronja l), të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas shqyrtimit të kërkesës së Shoqatës “Zona e Pashtrikut” nr. 01-030/2724 të datës 05.03.2026, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më __ mars 2026, miratoi këtë:

PROPOZIM-VENDIM
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR SHOQATËN “ZONA E
PASHTRIKUT”

Neni 1

Me këtë Vendim, ndahen mjetet financiare për Shoqatën “Zona e Pashtrikut” për mbulimin e shpenzimeve lidhur me përfundimin e projektit të shtatores së Heroit të Kombit “Tahir Sinani”, në shumën prej 30.000 € (tridhjetëmijë euro).

Neni 2

Mjetet e përshkruara si në nenin 1 të këtij vendimi, do të alokohen në xhirollogarinë e Shoqatës “Zona e Pashtrikut”

Neni 3

Shuma e mjeteve financiare të përshkruara si në nenin 1 të këtij vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi, 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesues i Kuvendit
Simir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Belediye Meclisi

No. 001/011 –

Tarih: __ Mart 2026

03/L-040 sayılı Yerel Öz Yönetim Kanunu’nun 12. maddesinin 1. ve 2. fıkrası (d) bendi, 40. maddesinin 2. fıkrası (c) bendi, 17. maddesi (g) bendi ve 58. maddesi (h) bendi; ayrıca 15.10.2008 tarihli ve 01/011-5643 sayılı Prizren Belediyesi Tüzüğü’nün 27. maddesi (l) bendi, 25. maddesinin 1. fıkrası (c) bendi ve 50. maddesi (l) bendine dayanarak; “Zona e Pashtrikut” Derneği’nin 05.03.2026 tarihli ve 01-030/2724 sayılı talebinin görüşülmesinin ardından, Prizren Belediye Meclisi __ Mart 2026 tarihinde yapılan toplantısında aşağıdaki öneri-kararı onaylamıştır:

“ZONA E PASHTRIKUT” DERNEĞİNE MALİ KAYNAK TAHSİSİ HAKKINDA ÖNERİ KARARI

Madde 1

Bu Karar ile, “Zona e Pashtrikut” Derneği’ne, Ulusal Kahraman “Tahir Sinani” heykelinin tamamlanmasıyla ilgili giderlerin karşılanması amacıyla 30.000 € (otuz bin euro) tutarında mali kaynak tahsis edilmiştir.

Madde 2

Bu kararın 1. maddesinde belirtilen mali kaynaklar, “Zona e Pashtrikut” Derneği’nin banka hesabına aktarılacaktır.

Madde 3

Bu kararın 1. maddesinde belirtilen mali kaynakların tutarı, Belediye Başkanı Ofisi’nin sübvansiyonlar ve transferler bütçe pozisyonundan sağlanacaktır.

Madde 4

Bu kararın uygulanmasından: Belediye Başkanı ve Ekonomi ve Maliye Müdürlüğü sorumlu olacaktır.

Madde 5

Bu karar, Belediyelerin İşlemlerinin İdari İncelenmesine ilişkin 08/L-284 sayılı Kanun’un 8. maddesi ile bağlantılı olarak 9. maddesi uyarınca, denetim organına gönderilmesinden 30 gün sonra ve belediyenin resmi internet sitesinde resmi dillerde yayımlandıktan sonra yürürlüğe girer.

Meclis Başkanı
Simir Krasniqi



SHOQATA ZONA E PASHTRIKUT

LËNDA: KËRKESË

- Drejtuar kryetarit të komunës së Prizrenit, gjegjësisht Asamblesë Komunale Prizren, që në bazë të kërkesave të bëra më heret nga Organizata e Veteranëve dhe Familjeve të Dëshmorëve dhe në bazë të zotimit të kryetarit të komunës dhe stafit të tijë, të mundësohet financimi për projektin e shtatorës së Heroit Tahir Sinani (ish-kom. të Zonës së Pashtrikut) në shumën prej tridhjetë mijë euro (30,000), e cila shtatore është ngritur nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Prizrenit Shaqir Totaj, bazuar në të gjitha procedurat dhe lejet përkatëse nga të gjitha drejtoritë komunale.
- Shoqata - Zona e Pashtrikut ka udhëhequr të gjitha punimet dhe ka kërkuar ndihmë financiare edhe nga Komunitet tjerë të Zonës së Pashtrikut, në mënyrë që bashkarisht të përfundohet i gjithë projekti i shtatorës së Heroit të Kombit Tahir Sinani, projekt i cili nderon Komunitetin tonë dhe gjithë Kombin.
- Mbesim me shpresë që kërkesa jonë të realizohet në një afat sa më të shkurtër për shkak të obligimeve financiare që kemi ndaj kompanive (gjegjësisht skulptorëve dhe kompanisë së bronzit).

Bashkangjitur keni të dhënat e Shoqatës - Zona e Pashtrikut:

Nr. fiskal: 00 [redacted]


Emri i bankës: PRI BANK

IBAN: [redacted]

Konto: [redacted]

Shoqata - Zona e Pashtrikut

15.09.2025 Prizren





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kuvendi i Komunës

Nr. 001/011-

Më: __ mars 2026

Në bazë të nenit 12 paragrafit 1 dhe 2 pika d), nenit 51 paragrafit 2, të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, nenit 27 paragrafit 1 dhe nenit 58 paragrafit 2, të Statutit të Komunës së Prizrenit, Nr. 01/011-5643 dt. 15 tetor 2008, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më __mars 2026, miratoi këtë:

PROPOZIM-VENDIM
PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE TË
KOMISIONIT PËR EMËRIMIN E RRUGËVE, SHESHEVE DHE LAGJEVE TË
